Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË NËNTË TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi kryetari, z.Bekim Azizi, kryesues i seancës së Kuvendit Komunal. Mbledhja është mbajtur më 25.09.2026, (e Premte), në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar punën në orën 10:00. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu, drejtorët komunal, mediat elektronike, si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Basri Aliu, z.Ramadan Deliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Ilir Zuka, z.Ekrem Ymeri, znj.Yllka Qamili, zn.Djellza Fejzullahu, z.Sokol Shaqiri, z.Faruk Shabani, z.Bekim Azizi, z.Hajdin Ademi, z.Visar Demiri, z.Nuhi Ramadani, z.Selim Sejdiu, znj.Elsa Jahija, znj.Ardita Hajdari, zn.Mirjeta Hamiti, z.Jakup Demiri, z.Ekrem Abazi, z.Lulzim Haxhiu, znj.Majlinda Shabani, zn.Liridona Bislimi. zn. Lindita Demelezi, z.Labinot Bislimi, z.Elham Emërllahu. Ndërsa munguan: z.Remzi Salihu dhe z.Bekim Rama.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e nëntë të rregullt. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit që janë në këtë seancë, veçanërisht përshëndetje për z.Alutrim Dermaku, përfaqësues i OJQ-së GYEK, i cili e monitoron seancën, që e kemi marrëveshjen me GAP-in. Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur ndonjë vendim që është kthyer si i jashtëligjshëm, të miratuar nga Kuvendi; të gjitha që janë kthyer janë në përputhje me normat dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Para se me fillu seancën, e kemi përfaqësuesin që do ta monitorojë Kuvendin. Ata kanë kërkuar fjalën për një sqarim para jush.

znj.Qëndresa: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, faleminderit shumë për bashkëpunimin dhe mundësinë që të jemi sot këtu prezent me ju. Siç jeni të njoftuar paraprakisht, konsorciumi, i cili përbëhet nga organizatat AFRC, GAP dhe GLGI, në kuadër të projektit "Monitorimi i Kuvendeve Komunale", me qëllim të promovimit të performancës së anëtarëve të kuvendeve komunale, i cili bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian, Qeveria e Zvicrës dhe Suedisë, ka filluar procesin e monitorimit të anëtarëve të kuvendit komunal. Procesi ka filluar nga muaji korrik i këtij viti dhe do të zgjasë deri në muajin mars të vitit të ardhshëm. Prandaj, edhe sot do t'ju njoftoj se cila do të jetë metodologjia që do të përdorim për këtë vlerësim dhe cili është qëllimi i këtij procesi. Një proces i cili synon të forcojë transparencën dhe llogaridhënien komunale nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe dokumentimit të performancës së anëtarëve, si dhe promovimin e praktikave më të mira. Ky është një proces i cili do të zhvillohet në tri kategori, përfshirë nëntë indikatorë: në rolin përfaqësues, legjislativ dhe mbikëqyrës. Në rolin përfaqësues, fokusi i monitorimit zhvendoset tek vlerësimi i angazhimit të asambleistit në takime me qytetarët, këshillat lokalë, grupet tjera të interesit, përfshirë dhe grupet e margjinalizuara, si dhe sa këto kërkesa nga këto grupe janë të paraqitura zyrtarisht në Kuvend. Në rolin legjislativ, fokusi i monitorimit zhvendoset tek vlerësimi i angazhimit të asambleistit në paraqitjen e rekomandimeve për shqyrtimet e akteve komunale të ndryshme. Ndërsa, në rolin mbikëqyrës, fokusi i monitorimit është i zhvendosur tek vlerësimi i rolit të asambleistit në kërkesa për llogaridhënie drejtuar ekzekutivit, lidhur me raportet dhe dokumentet e tjera të cilat janë të paraqitura në seancat e Kuvendit Komunal. Prandaj, të gjithë këta indikatorë e bëjnë vlerësimin tuaj në terren dhe në seancat e Kuvendit. Pas procesit të monitorimit do të ndahen tri çmime në nivel të Kosovës: çmimi për anëtarin më aktiv në Kuvendin Komunal, çmimi për anëtaren më aktive, si dhe çmimi për mandatin më aktiv në mandatin e parë. Të gjitha këto vlerësime janë të mbështetura në dokumentacion, në procesverbale, video-incizime, lista të pjesëmarrjes,

takime që mbani në terren dhe në forma të tjera. Çka duhet të keni parasysh është që nga ky proces i vlerësimit janë të përjashtuar kryesuesi i Kuvendit, si dhe shefat e grupeve, duke pasur parasysh rolin dhe përgjegjësitë ekstra që i kanë në përfaqësim dhe koordinim, si dhe në mënyrë që të sigurohet që ky proces të jetë një reflektim i vlerësimit të punës individuale të secilit asambleist. Në vazhdim do të keni për çdo seancë monitorim dhe monitoruesin nga GAP-i. Nëse keni pyetje apo paqartësi, mundeni me iu referu.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Unë ju falënderoj të gjithëve që kohëve të fundit kemi qenë të gjithë së bashku në përkrahje të njerëzve të UÇK-së, të cilët mendojmë që padrejtësisht është dënuar liria dhe lufta e Kosovës. Kjo mbështetje që po i jepet gjithë popullit, po i jepet mbështetje shtetit, vendit, sakrificës, luftës, lirisë tonë në përgjegjësi. Faleminderit shumë. Materialin e keni marrë me kohë. Në kuadër të materialit që keni marrë për dëmet, kompensimi i dëmeve materiale, e keni marrë vetëm pjesën e bujqësisë, ndërsa tash ka ardhë dhe materiali në ekonomi, për shkak se nuk ka mujtë me u bë përmbledhja deri në komitet të gjithë. Tani e keni edhe pjesën tjetër dhe kompletohet materiali kur të diskutohet. Para se me miratu rendin e ditës, unë kam një propozim: deklaratën mbi vendimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së. Për këtë deklaratë jemi në koordinim me të gjitha grupet, me ekzekutivin; të gjithë së bashku e kemi pru për miratimin e kësaj deklarate së bashku. Kisha kërkuar që në rend të ditës të hyjë edhe miratimi i deklaratës, të shprehim qëndrimin tonë që dënimi nuk është bërë në emër të popullit, por populli e ka përkrahjen për njerëzit e UÇK-së. Para se me qitë në votim, unë kisha kërkuar që kjo pikë e rendit të ditës, pas procesverbalit, të hyjë si pikë e parë, ta kryejmë dhe vazhdojmë me rendin normal.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Për pikën shtesë të rendit të ditës jemi dakorduar edhe më herët, por unë e kam një pikë tjetër që dua me diskutu. Ajo është dashtë me ardhë prej ekzekutivit. Është raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, që edhe këtë vit komuna jonë nuk e sjell në Kuvend, kur e dimë që afati ligjor për ta sjellë në Kuvend është 30 shtatori. Komuna i humb 2 pikë në Grantin e Performancës për mos sjelljen e raportit të Auditorit Kombëtar në Kuvend. Këtë e kam folë edhe në KPF, por neve nuk na ka ardhë.

znj.Majlinda Shabani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kam një pyetje për ekzekutivin lidhur me pikën që kemi për Projektbuxhetin e Komunës së Vitisë. Edhe, siç po e shohim, neve na ka ardhë lista e projekteve të investimeve kapitale tash, dmth. para se me fillu seanca, kur është dashtë me u përcjellë me draft. Para se me fillu diskutimi, kisha dashtë me ditë arsyen pse na ka ardhë me vonesë dhe pse nuk është kry me kohë kjo listë.

z.Basri Aliu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Në emër të grupit, pajtohem me pikat që u propozuan. Kisha dashtë që të mos kalojmë jashtë rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Për këtë seancë kemi paraparë këtë rend të ditës:

R e n d d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit Komunal.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2027-2029.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-110/05-490, të datës 04.05.2026, për kthimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale**.
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e raportit për vlerësimin e dëmëve të shkaktuara në Komunën e Vitisë.**
5. **Informatë për përfundimin e vitit shkolle 2025-2026, fillimi i vitit shkollore 2026-2027.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për vënie në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale komunale të Vitisë 2026-2034.**
7. **Pyetje dhe përgjigje.**

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Hapi debat për rendin e ditës. Pasi që nuk ka për debat, e qes në votim. Me të gjitha votat për, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim, miratohet edhe rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit Komunal

z.Elham Emërllahu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Në seancën e kaluar, më 30 korrik, kam pas diskutim dhe replikë, por kundërreplika jem me kolegen nga VV-ja, znj.Majlinda, nuk figuron. Tema ka qenë për dëmet në bujqësi dhe ekonomi familjare. Kundërreplika jem nuk ka hy fare. I bjen që unë jam pajtu atë ditë me atë deklaratë, por në fakt nuk jam pajtu.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Besoj që e shikojnë dhe e plotësojnë, por duhet me ditë që pjesët, nëse nuk i jepet fjala, nuk hyjnë në procesverbal. Pra, a jeni që të miratohet rendi i ditës me vërejtjen që dha Elhami? Me të gjitha votat për, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim, miratohet edhe procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim Deklaratë mbi vendimin e dhomave të specializuara të Kosovës në Hagë ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Kuvendi i Komunës së Vitisë, duke respektuar pavarësinë e gjyqësorit, shpreh mospajtimin e tij të thellë me aktgjykimin e shkallës së parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, të datës 16 shtator 2026, ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Presidentit Hashim Thaçi, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Kuvendi rithekson se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte vazhdimësi e luftës për liri dhe çlirim, e lindur nga rrethanat e rënda të represionit, dhunës, vrasjeve dhe dëbimit të popullsisë shqiptare të Kosovës. Kuvendi konsideron se, për një dënim penal të kësaj peshe, përgjegjësia personale e secilit të akuzuar duhet të provohet me prova të qarta, konkrete, bindëse dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Kuvendi shpreh shqetësimin e tij se përgjegjësia penale individuale nuk duhet të ndërtohet mbi supozime, përgjithësime, dëshmi të tërthorta apo mbi lidhje të nxjerra nga pozitat politike dhe ushtarake që individët kanë mbajtur gjatë luftës. Kuvendi vlerëson se vetë Trupi Gjykues ka shpallur të akuzuarit të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit, pasi është konstatuar se Prokuroria nuk kishte arritur të provonte, përtej dyshimit të arsyeshëm, ekzistencën e një sulmi të përhapur ose sistematik kundër popullatës civile. Po ashtu, pafajësi janë dhënë lidhur me një numër incidentesh të tjera të pretenduara. Për këto arsye, kërkojmë: të mbështeten përpjekjet institucionale për mbrojtjen dhe dokumentimin e së vërtetës historike për luftën e Kosovës; Të kërkohet që krimet e kryera ndaj popullsisë civile të Kosovës të trajtohen me drejtësi dhe pa standarde të dyfishta; Të kërkohet që të gjitha mjetet juridike në dispozicion për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin të ndiqen deri në fund, në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor. Duke pasur parasysh se vendimi është shpallur me formulimin "Në emër të popullit të Kosovës", Kuvendi Komunal i Vitisë përcjell qartë mesazhin e qytetarëve të tij: **"JO NË EMRIN TIM!"** Ky qëndrim shpreh mospajtimin me dënimin e shqiptuar dhe të drejtën e qytetarëve për të kërkuar drejtësi dhe trajtim të drejtë për ish-krerët e UÇK-së: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

z.Basri Aliu: Ne, edhe në konsultimin e mëparshëm që kishim, të gjithë u pajtuam që kjo deklaratë të qitet në Kuvend, në mënyrë që të jemi në përkrahje të krerëve të UÇK-së. Nuk dua të shtoj asgjë më tepër për deklaratën të cilën e lexuat ju.

z.Visar Demiri: Edhe ne, si grup parlamentar, kemi qenë në proces të hartimit dhe konsultimeve për këtë deklaratë kundër gjykimit të padrejtë që është bërë në Hagë kundër udhëheqësve të UÇK-së. Ne e përkrahim në plotni këtë deklaratë.

z.Jakup Demiri: Dhe ne, si grup parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, mbështesim dhe votojmë këtë deklaratë në mbrojtje të krerëve të UÇK-së dhe UÇK-së.

z.Labinot Bislimi: Edhe ne, si Aleancë, e përkrahim deklaratën dhe të gjitha protestat të cilat vijojnë në vazhdimësi në Prishtinë dhe në qytetet e tjera.

z.Elham Emërllahu: Në cilësinë e asambleistit dhe subjektit politik që përfaqësoj, Nisma Socialdemokrate, në koordinim me grupet parlamentare, e mbështesim plotësisht deklaratën dhe konsiderojmë që Gjykata e Hagës ka bërë një cenim të rëndë të lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit tonë. Lufta e UÇK-së ka qenë luftë e

drejtë, luftë çlirimtare, e cila është bazuar në luftën për të cilën Serbia dhe regjimi serb kanë bërë krime në Kosovë. Prandaj, ky gjykim është i padrejtë dhe jo në emrin tonë. Pajtohemi plotësisht me këtë deklaratë dhe vota ime do të jetë pro.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Pra, e qes në votim. Me të gjitha votat për, 25 të pranishëm, 25 për, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim, miratohet edhe deklarata.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-110/05-490, të datës 04.05.2026 për kthimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: E dini që buxheti duhet të mriatohet deri me 30 shtator, buxheti miratohet për vitin 2027 dhe projeksionet e buxhetit për 3 vite radhazi miraothet dhe projeksioni i buxhetit në të ardhmen.

zn.Melihate Ajeti, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Buxheti i komunës për vitin 2027 parashihet që të jetë prej 18 milionë e 388 mijë e 643 euro. Me këto burime të financimit: granti qeveritar, që përfshin grantin e përgjithshëm, grantin e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve, në shumë prej 17 milionë e 54 mijë e 305 euro, dhe të hyrat vetanake në shumë prej 1 milion e 334 mijë e 338 euro. Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2027, sipas burimeve të financimit: granti i përgjithshëm është 8 milionë e 898 mijë e 299 euro, granti specifik i arsimit është 5 milionë e 930 mijë e 173 euro, granti i shëndetësisë 2 milionë e 70 mijë e 833 euro, granti i shërbimeve rezidenciale 155 mijë euro, dhe të hyrat vetanake 1 milion e 338 mijë euro. Buxheti i Komunës së Vitisë për këtë vit, në total, ka një rritje prej 64 mijë e 228 euro, me përqindje 0.35%. Rritja e reflektuar nga granti i përgjithshëm është 1 milion e 193 mijë e 234 euro, zvogëlimi nga granti i arsimit është 1 milion e 269 mijë e 785 euro, dhe rritja e grantit të shëndetësisë është 101 mijë euro, ku në total qeveria ka rritje prej 24 mijë e 750 euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar një rritje prej 39 mijë e 678 euro. Nga ky buxhet që parashihet për vitin 2027 dhe në bazë të nevojave, buxheti është i ndarë në kategori ekonomike: Paga dhe shtesa: 11 milionë e 487 mijë e 849 euro; Mallra dhe shërbime: 3 milionë e 13 mijë e 919 euro; Shpenzime komunale: 299 mijë euro; Subvencione: 720 mijë euro, të cilat kanë mbetur të njëjta si vitin e kaluar; Shpenzime kapitale: 2 milionë e 833 mijë e 875 euro. Në total e kemi shumën 18 milionë e 388 mijë e 643 euro. Për kategorinë "Paga dhe shtesa" kemi rritje të shpenzimeve prej 610 mijë e 624 euro. Në këtë kategori ndikon rritja e punëtorëve për hapjen e çerdhes parafillore, çerdhes së re që do të hapet dhe ndryshimi i përvojës së punës nga 0.25 në 0.5. Aty ka ndikuar rritja. Te kategoria "Mallra dhe shërbime" kemi zbritje prej 65 mijë euro në krahasim me vitin 2026. Kategoria e shpenzimeve komunale për vitin 2027 është e njëjtë me vitin 2026, ndërsa kategoria e subvencioneve dhe transfereve nuk ka ndryshim nga viti i kaluar. Kategoria e investimeve kapitale ka zbritje prej 481 mijë e 196 euro, ndërsa zbritja ka ndodhur në kategorinë e shërbimeve, mallrave dhe investimeve kapitale, se rritja e buxhetit ka qenë vetëm 64 mijë e 428 euro. Për mbulimin e kategorisë për rritjen e pagave, jemi detyruar që t'i zvogëlojmë kategoritë, duke u bazuar në qarkoren buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave. Kjo ishte në pika të shkurtra, por t'i them edhe projeksionet: për vitin 2028 është 18 milionë e 319 mijë e 667 euro, ndërsa për vitin 2029 është 19 milionë e 292 mijë e 38 euro.
Kaq kisha. Për çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

znj.Elsa Jahija: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Sot kemi për shqyrtim Buxhetin e Komunës së Vitisë për vitin 2027, një nga vendimet më të rëndësishme që merr ky Kuvend. Si përfaqësuese e qytetarëve, do të votoj pro këtij buxheti. Megjithatë, e konsideroj të domosdoshme t'i paraqes disa vërejtje, me qëllim që planifikimi dhe shpenzimi i mjeteve publike të jenë më të qarta dhe më të përgjegjshme. Së pari, mënyra se si janë trajtuar obligimet financiare të komunës kërkon më shumë vëmendje. Duke pasur parasysh barrën e borxheve dhe ndikimin e përmbarimeve në buxhet, kërkoj të sqarohet sa është vlera e obligimeve të mbledhura dhe çfarë plani konkret ka ekzekutivi për t'i përmbushur ato gjatë vitit 2027, pa cenuar realizimin e projekteve të planifikuara. Një pjesë e projekteve vazhdojnë të paraqiten në kategori tepër të përgjithshme, pa identifikim të veçantë buxhetor. Për shembull, te kodi i asfaltimit të rrugëve rurale në Komunën e Vitisë, qytetarët duhet

të dinë se për cilat rrugë bëhet fjalë, nëpër cilat lokalitete dhe sa mjete janë paraparë për secilën. Kërkoj që projektet të specifikohen qartë, në mënyrë që realizimi të mund të përcillet dhe kontrollohet nga Kuvendi dhe qytetarët. Gjithashtu, duhet një arsyetim më i qartë për renditjen e projekteve sipas përparësisë. Në shumë raste, nevojat e qytetarëve mbeten pa zgjidhje, ndërsa planifikohen ndërhyrje që mund të presin. Cilat kritere janë përdorur për t'i përzgjedhur projektet për vitin 2027 dhe si janë marrë parasysh kërkesat më urgjente të qytetarëve? Shpresoj shumë që viti 2027 të jetë më i qëndrueshëm financiarisht për komunën dhe më i mirë për qytetarët e Vitisë, por duhet të jemi më realistë. Nëse nuk i trajtojmë seriozisht obligimet ekzistuese, ekziston rreziku që disa nga projektet që miratojmë sot të mbeten vetëm në letër. Për këtë arsye, vota ime pro buxhetit shoqërohet me përgjigje konkrete, më shumë transparencë gjatë zbatimit të tij dhe menaxhim më të kujdesshëm të parasë publike.

z.Jakup Demiri: Te kjo pikë e rendit të ditës, që është ndoshta vendimi më i rëndësishëm në Kuvendin Komunal, unë këtu e shoh një jo-seriozitet të madh të ekzekutivit. Ne në KPF u pajtuam që kjo listë, jo kjo se kjo është e përgjysmuar, sikur mos me pru hiç, me na ardhë dy ditë përpara, me i analizu, me i kqyr. Se në këtë listë ke ndërtimin e fushave sportive në 7-8 fshatra. Sa janë? 200 mijë euro, dmth. gjysmën e fshatrave të Komunës së Vitisë me 200 mijë euro me i ndërtu palestra sportive. Këtë e kemi qe pesë vite rresht. Kjo nuk është që ka ardhë në listë, këtë veç e ke nxjerrë dhe e ke pru. Ne u dakorduam që me na ardhë dy ditë përpara, me e analizu dhe me pasë për çka me folë. Për këtë punë qe tre muaj dakordohemi me na ardhë lista e borxheve: cilat janë të kontratave kolektive, cilat janë të operatorëve ekonomikë. Qe 5-6 muaj dakordohemi me na ardhë lista e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomikë. Kjo është baza për me hartu një buxhet. Tani e di ku je, se ne nuk e dimë sa borxhe kemi dhe nuk e dimë sa pare kemi në dispozicion. Parafolësja më së pari tha: "E votoj", tani jap rekomandime. Jo, nëse kalon këtu, ne e dimë se si funksionon komuna jonë. Beso që nuk ka vullnet as me diskutu për materialin. Veç edhe një vërejtje jap: te planifikimi i të hyrave vetanake, një komunë e cila i planifikon të hyrat vetanake këtu janë 7.2%, që planifikon nën 10% të buxhetit të tërësishëm, është komunë e paaftë për vete. Edhe këtë ta keni parasysh, se në fund kështu cilësohet. Po dal edhe te një pikë që thashë me shti në rend të ditës: raportin e Auditorit Kombëtar. Është viti i 3-4 që komuna humb Grantin e Performancës dhe askush nuk jep përgjegjësi për këtë punë. Nuk kanë vullnet as me diskutu, veç me pru raportin këtu. Ti i shpëton 2 pikë me 6 pikë, ti e humb Grantin e Performancës. Sa jemi ne të përkushtum te financat e shtetit apo te projektet e qytetarëve, përime unë nuk e di. Si nuk fole drejtoresha hiç për asnjë projekt? Hajde fol për këto projekte, me na thanë diçka. Ndërtimi i kanalizimeve në territor të Vitisë, 230 mijë euro. Me krejt kanalizimet kemi problem e asnjë kanalizim nuk e di që ka pranim teknik. I kanë bërë disa para 15 vjetëve në Smirë, për shembull. Në Smirë mbi 10 vite, dhe askush nuk qanë kokën për të. Ne më herët jemi marrë vesh që investimet kapitale me i zvogëlu sa më shumë, që me i kry këto obligime, se tani kemi problem edhe me çështjet e faturave kur paguhen më vonë, në çështjen e kamatave. Nëse fatura nuk paguhet një muaj, fillon diku me 8%. Sa më shumë që vonohet ajo faturë, shkon kamata më e lartë. A dinë dikush me ma dhanë një përgjigje sa borxhe i ka Komuna e Vitisë ndaj operatorëve ekonomikë? Tani flasim për buxhetin. Nëse këtu nuk flasim, ku me folë? Me syh me votu këtë Projektbuxhet? Çdo vit flasim dhe shkon tu na u rritë buxheti, edhe për mosseriozitetin tonë që kemi këtu. Lehtë është me votu dhe me ecë të shpija, por tani më vonë çka po na ndodhë? Komuna e Vitisë nuk ka derivate për vetura me dalë me i kqyr projektet, e këtu votojmë buxhetin e vitit të kaluar pa e diskutu, pa u marrë askush seriozisht. Pak është mirë me mbajtë jashtë KPF-së edhe një mbledhje, për shkak të situatës së jashtëzakonshme që e ka komuna jonë, ndoshta edhe shumë komuna tjera. Por ne jemi të komunës sonë dhe jemi të thirrur për këtë komunë, jo për komuna tjera. Me mbajtë një takim dhe me folë sinqerisht çka me ba për buxhetin, se nesër kollapsojmë krejt. Askush nuk na e qan hallin. Ne jemi ata që e shkokojmë problemin, askush tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: E dimë që vlera e buxhetit dhe kriteret që caktojnë vlerën e përgjithshme, të hyrat vetanake, grantet specifike, që caktohen përmes formulës bazë, numrit të banorëve, territorit, shkollave, nxënësve etj., ndërsa shpërndarja është kjo që keni përpara dhe mundë të diskutojmë. Është e dhimbshme që kemi vlerë të vogël të investimeve kapitale, nën 3 milionë, por megjithatë ky është buxheti i tillë që duhet të miratohet.

znj.Majlinda Shabani: Natyrisht që ne e dimë që, kur diskutohet Projektbuxheti i Komunës së Vitisë për tri vitet e ardhshme, është njëra prej dokumenteve më të rëndësishme. Natyrisht që, duke e marrë parasysh që komuna paraprakisht i plotëson disa procese, mandej arrin deri në përfundim, deri në formulimin e draftit të Projektbuxhetit, ke pasë dëgjime buxhetore, Kornizën Afatmesme Buxhetore, të cilat është dashtë me u marrë parasysh, dhe krejt në fund çka na bjen neve është një draft, i cili i ka kategoritë e ndara. Natyrisht që ajo është specifikë shumë thjesht në krahasim me çka ne duhet me diskutu si asambleistë të Kuvendit Komunal. Tjetra, që keni bërë thirrje për seancë të Kuvendit Komunal, që seanca me qenë e hapur, me qenë edhe për qytetarët. Dhe, kur kthehemi me bë pyetjen se çka ju intereson qytetarëve të Komunës së Vitisë me ditë, natyrisht që janë investimet kapitale.Kur të mbërrijmë te investimet kapitale, ajo që shihet në dokumentin që ju keni prezantuar dhe keni bërë publik është që lista e investimeve kapitale mungon. Jemi tu e diskutu një listë e cila ish dashtë me qenë prioritet në këtë draft të Projektbuxhetit të Komunës së Vitisë: me u ulë me diskutu projektet, vizionin që Komuna e Vitisë e ka, prioritetet, gjithëpërfshirjen, balancimin. Por këto ne nuk po i shohim asnjë prej tyre. Shkurt e shqip, është një fontanë dëshirash e kryetarit të Komunës së Vitisë, i cili edhe sot po mungon në këtë seancë të Kuvendit Komunal dhe që shihet se sa seriozisht e trajton këtë çështjen e parasë publike. Sa i përket transparencës, që kemi potencuar disa herë, mendoj që çështja e transparencës ka filluar me u bërë një çështje serioze dhe alarmante për sa i përket Komunës së Vitisë. Gjë e cila tash po tregohet edhe përmes raporteve të fundit të Institutit GAP, te Indeksi i Transparencës Buxhetore, ku Komuna e Vitisë është renditur me indeksin e transparencës buxhetore në mesin e komunave me indeks më të ulët të transparencës në vend. Në vend se me u ulë me diskutu për me përmirësu jetën dhe mirëqenien e qytetarëve, me i rendit projektet, me i pa prioritetet, ne thjesht jemi tu e pru shabllon një Projektbuxhet dhe që ka me u legjitimu me votën tonë. Unë sot kam prit që ky diskutim, për sa i përket projekteve, me qenë shumë i koncentruar, me pasë një gjithëpërfshirje dhe qytetarët e Komunës së Vitisë, duke e përfshi secilin lokalitet, me ditë se cili projekt ka hy për atë fshat këtë vit, cili për vitin 2028 dhe cili për vitin 2029. Mendoj që kjo praktikë, mënyra se si është tu funksionu Komuna e Vitisë, është tu e tregu dështimin e saj, që nuk ka kurrfarë vizioni për Komunën e Vitisë, nuk ka kurrfarë vizioni për zhvillim ekonomik dhe ka dështuar në menaxhimin e parasë publike. Andaj, për mua është shqetësuese kjo mënyrë e diskutimit sot, se si jemi tu e votu buxhetin kur e dimë që është shumë me rëndësi dhe, në fund, veç kalohet në heshtje. Nuk e ke prezent kryetarin e komunës. Arsyet nuk i dimë. Vjen një herë apo dy herë në vit, në vend se me qenë këtu me diskutu, dhe del, arsyetohet dhe shpreh fontanën e dëshirave të tij në buxhetin e Komunës së Vitisë, e cila normalisht që duhet me i taku qytetarëve të Komunës së Vitisë. Kjo, për mua, është e papranueshme dhe shumë shqetësuese.

z.Elham Emërllahu: Pajtohem me Majlindën te pjesa e fundit. Kryesues, të kisha lutë që përgjigjet në aspektin e politikave të ekzekutivit t'i japë ekzekutivi. Ti e ke obligim me mbarëvajtë seancën, dhe asambleistët kanë të drejtë me diskutu.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Duhet me diskutu për rendin e ditës brenda rendit të ditës. Nëse kemi diçka jashtë rendit të ditës, atëherë mundemi me diskutu, por tani jemi tu diskutu për pikën që është në rend të ditës.

z.Elham Emërllahu: Jemi te rendi i ditës, mandej drejtoresha dhe nënkryetari pastaj munden me dhanë ato të cilat ne po i kërkojmë. Edhe unë shprehi pakënaqësinë teme që ky raport që na ka ardhë sot është me vonesë, dmth. edhe duhet pak me analizu, me pa. Unë dhe në mëngjes, me kolegë asambleistë që kemi diskutu, kemi pasë këtë shqetësim: pse nuk kanë ardhë listat e projekteve të caktuara nëpër lokalitete që i ka paraparë ekzekutivi për vitin 2027-2028 e tutje? Qe tri ditë e fundit jam mundu pak më shumë me analizu Projektbuxhetin, sidomos për vitin 2027, sepse të gjithë e kemi ditë që ky vit që po shkon ka qenë i vështirë edhe për komunën tonë, edhe për komunat tjera, për shkak të obligimeve me përmbarues dhe kontratës kolektive. Por nuk kam parë ndonjë ndryshim. Është një retorikë e njëjtë ose një Projektbuxhet i njëjtë që është planifiku. Për mos me thanë që vitin e ardhshëm, sidomos te investimet kapitale, gati gjysmë milioni janë më pak. Drejtoresha e tha që vitin e ardhshëm është parapa rritje veç 64 mijë euro, nëse nuk gaboj. Edhe unë këtu duhna me bë pyetje: pse? Tu mos i përmend obligimet të cilat i ka komuna për vitin e ardhshëm, që e tha edhe z. Jakupi, që nuk i dimë cilat janë, edhe të punëkryesve dhe të përmbaruesve. Mandej munden me na dalë

vështirësi për tri vitet e ardhshme. Nuk kam parë rritje as në subvencione në bujqësi, as në kulturë, rini e sport, po as në investime kapitale. Kjo është ndoshta pak e habitshme. Po, me gjithë këtë kërkesë, nëse rriten shpenzimet në derivate dhe në gjëra të tjera, edhe klubet futbollistike, edhe sportistët, bujqit etj., atyre u rriten shpenzimet. Prandaj, mos me parapa rritjen e numrit të mjeteve për subvencione, mu mu ka dokë pak e pakuptueshme. Prandaj, këtu është problemi më i madh, sepse kjo shpërndarja e njëjtë që e përcjell Komuna e Vitisë është shpërndarja e njëjtë e buxhetit që sa vite, e po shihet që ka me qenë edhe vitet e ardhshme. Po u dashtë me menu pak më shumë, sidomos te subvencionet, se për investime kapitale po e shofim se kemi rënie gati gjysmë milioni.

z.Nuhi Ramdani: Përshëndetje, të nderuar të pranishëm. Unë po e shoh këtë: në fshatin Verban nuk ka parapa kurgja. Unë i kam kërkesat e mia që i kam dorëzu. Nënkryetari më ka thanë: "Krejt buxheti i Komunës së Vitisë, kërkesat e tua nuk realizohen." Kërkesat e mia, në shikim, mundë të duken të shumta, po në realitet janë shumë modeste karshi nevojave të banorëve. I kuptoj unë që edhe fshatrat tjera kanë kërkesa, po realisht këto janë kopi-pastë. Fusha e sportit në Verban, kjo u kry që katër vite. Asnjë specifikim nuk është. Po më vjen keq, na kemi nevojë për ujë të pijshëm, sepse nuk kemi ujë. Unë nuk muj me e votu qetë. Nuk ka të specifikuara asgjë.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje, të nderuar të pranishëm. U thanë disa gjëra, e mos t'i përsërisim. Temë kryesore për me bisedu sot ka qenë investimet kapitale, po materiali, si përherë, po e marrim vërejtjen bash për pikën më të kyçur që na duhet me diskutu për të mirën e qytetarëve. Material nuk kemi. Unë as nuk e shfletova se çka ka në atë material, po e di se çka ka, se aty vetëm paushalla merren. Nuk definohen kurrë se ku kemi investu, vetëm numri i përgjithshëm: sa shkojnë për zhavorr, sa për rrugë të asfaltuara e sa për të tjera. Pastaj, te investimet kapitale, në krahasim të vitit 2026 me vitin 2027, ku në vitin 2027 kemi 481 mijë euro më pak te investimet kapitale, ku dihet që edhe këtë vit 50% e ka marrë kontrata kolektive. Tash propozoj që nga të hyrat vetanake për vitin 2027, së paku 200 mijë euro të barten te investimet kapitale. E di që këto ka me i marrë përmbaruesi, por më mirë me pas pak më tepër pare edhe me ditë që po shkojnë te qytetari. Këto muj me i marrë prej subvencioneve, prej Zyrës së Kryetarit, një pjesë te shërbimet dhe mallrat dhe me i qitë te investimet kapitale. Listën e borxheve nuk e kemi. A i plotësojnë këto investimet kapitale krejt borxhet që i kemi ndaj njerëzve që kanë kry punë dhe nuk janë pagu?

z.Ilir Zuka: Përshëndetje, të nderuar të pranishëm. Unë edhe në KPF, kur u patë diskutu për me i mbajtë dëgjimet buxhetore, kam thanë me gjetë një formë me u pajtu si institucion, krejt si parti politike, që në vitin 2026, sa më pak projekte me mujtë me i mbulu obligimet që i kemi ndaj firmave, ndaj gjithkujt. Se na po hapim projekte të reja, po vetëm sa po hymë në borxhe. Na e dimë që kontrata kolektive në Komunën e Vitisë e ka shkatërru dhe është problem edhe në vitin 2026. Na i kemi shumë projekte, ka projekte që janë shumë të mira, po na e dimë që është problem me i ekzekutu këto projekte, tu e ditë se përmbaruesi nuk na le asnjë projekt me e nisë. Po lidhem edhe te tjetra, primare për Pozharanin, që sa vite është domosdoshmëri: është stadiumi "Ibrahim Kurteshi" me u kompletu. E dimë problemin me tribuna, e dimë që prapë e kanë shti si kod buxhetor, po qytetarëve të Pozharanit nuk po ju konvenon si kod, po po u duhen tribunat, sepse ata çdo të diel po dalin me pa futboll. Edhe e di që sa problem te komuna. Uroj që të bëjmë zgjidhje.

z.Basri Aliu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Te kjo pikë e rendit të ditës, tu i ditë vështirësitë të cilat ndodhin në komunë, e sidomos ekzekutivi që janë paraqitë, dmth. prej kontratës kolektive dhe e kanë lanë komunën me buxhet të varfëruar, në atë kuptimin e obligimeve të cilat i ka komuna. Duke e ditë që komunat kanë nevojë për buxhet shtesë, atëherë pak a shumë u dashtë të mendohet edhe nga Qeveria, e cila është momentalisht, që të korrigjohet buxheti dhe t'i jepet një farë infuzioni edhe komunave të cilat kanë vështirësi. Se nuk jemi vetëm ne, Komuna e Vitisë, po të gjitha komunat janë në këto vështirësi. Si e përmendi edhe dikush prej kolegëve, tha se problem është edhe për naftë me dalë në teren me i kry edhe punët të cilat vetëm duhet të kryhen. Të hyrat vetanake këto i përcakton niveli qendror, dmth. shumicën e kuadrove buxhetore i përcaktojnë atje, te pagat dhe meditjet, që veç janë të përcaktume numrat, dhe shumica e buxhetit është e orientume në paga dhe meditje. Te investimet kapitale, te lista, po kam vërejtje në atë kuptim. Është dashtë më

herët të vijë lista, por këto gabime munden me qenë edhe teknike. Majlinda, a kishe mundë me na ndihmu në rrugën e Budrikës, që e ka për detyrë Qeveria me e rregullu dhe që ka mbetë gati qe dy vite e papërfundume? Për atë e dimë sa ka punu kjo Qeveri. I ka shpërnda ka 100 euro. Kjo është e arritura më e madhe e kësaj Qeverie, edhe atë para zgjedhjeve. Te lista shihen projektet, por janë edhe projekte që janë 2-3-vjeçare. Prandaj edhe ato përsëriten në këtë listë, sepse me këtë buxhet kanë me përfundu ato, nëse lejojnë me i përfundu përmbaruesit. Ne, si grup parlamentar, me mundësitë që ka komuna, tu i ditë vështirësitë, në parim jemi me e përkrahë buxhetin komunal.

z.Labinot Bislimi: Ne e kemi diskutu edhe herave tjera në këtë kuvend për qështjen dhe dallimin mes asaj që na ofrohen si kode kontable, të cilat i kuptojmë, edhe atyre që janë politika ekonomike apo projektet, për të cilat edhe kolegët e mi i cilësojnë si të padefinum. Është e papranueshme për një komunë e cila vjen dhe prezanton projektbuxhetin, por nuk ka asnjë strategji ekonomike për 3 vitet e ardhshme: një copy paste i projekteve dhe një vazhdimësi 12-13 vjeçare me të njëjtin kaos. Se kaosi është në konfuzitetin e kokës së kryetarit më së pari dhe të gjithëve pastaj që e përcjellin këtë apo që ia bëjnë rrafsh – kjo me të vërtetë është e papranueshme. Unë e kuptoj që kontrata kolektive e ka rëndu buxhetin e komunës, por pasojat reale pse komuna e Vitisë ka mbetur kaq mbrapa është pikërisht se nuk ka strategji afatgjatë kjo komunë, për me mujtë me i mbulu pengesat e saj drejt zhvillimit. Kur e marrim vetëm këto faqe këtu, është e paimagjinueshme që asnjë projekt nuk është konkret, por më e keqja është se janë krejt projekte të vogla, dhe kjo është një ripërsëritje disavjeçare. Kur vjen puna për të zgjidhur probleme reale për këtë komunë, nuk e kemi asnjë – e tha Nuhiu më herët që Verbani ka nevojë për ujë, dhe shatërvanët e Vitisë në shumicë janë pa ujë, dhe ne nuk e kemi askund të specifikuar se si do ta bëjmë punën e ujit. Nuk e kemi askund në këtë kuvend seancat e tjera që kanë kaluar apo do të vijnë, për ta diskuktuar njëherë e mirë këtë qështje dhe për të gjetur një strategji të mirëfilltë që të zgjidhet problemi. Këtu flitet për kanalizimet, por cilat kanalizime? A e kemi diskutuar ndonjëherë për me pa se cilat janë nevojat reale të kanalizimeve në Viti? Është një rrjet i pamjaftueshëm, diku mbi 50% e komunës së Vitisë nuk është e kyçur në kanalizime, apo për gropat septike të cilat mungojnë. A e keni parë çfarë ere vjen kur kaloni nga Sllatina, por edhe ku të doni kaloni, keni me pa që Vitisë i vjen era kanalizim, e kjo është e papranueshme. Kjo, që ne nuk mundemi me shku paushall, nuk funksionon një komunë, një institucion me paushall dhe me projekte copy-paste, me i qitë në letër si kanë qenë e me vazhdu. Pra, mungon një strategji e mirëfilltë e politikave ekonomike, dhe ky është konfuziteti i një kryetari të komunës bashkë me ata që ia bëjnë rrafsh njëri-tjetrit. Në komunën e Vitisë gjithçka mund me funksionu në sektorin privat, mirëpo në sektorin publik me të vërtetë është në krizë shumë të thellë.

z.Visar Demiri: Nuk i di arsyet pse këto projekte të investimeve nuk kanë ardhur me material, gjë që mendoj se është pjesa më e rëndësishme e buxhetit komunal. Kjo pjesa tjetër që na ka ardhur kanë qenë paga, mëditje, shpenzimet, krahasimet, që nuk janë diçka të rëndësishme në krahasim me atë që qytetarët tanë kanë nevojë për investimet dhe kërkesat e tyre. Shpresoj që prioritetet janë bërë me kërkesat e qytetarëve dhe nevojat e tyre, mirëpo unë jam skeptik për shkak, si e thanë edhe kolegët tjerë, problemi kryesor i komunës së Vitisë është uji i pijes, dhe në këtë drejtim shoh më së pakti investime. Pastaj, grandi që tha drejtoresha është më i vogël në arsim, mbi 1 milion euro çfarë do të bëhet? A është kjo që është përfolur ditëve të fundit, që ka të bëjë me raportin nxënës-profesor? Ku do të merren këto para, ku do të paguhen profesorët nëse janë tepër në komunën e Vitisë, kur e dimë çfarë buxheti kemi? Përmbaruesit pothuajse janë duke e marrë çdo mjet që e ka në dispozicion komuna e Vitisë. Edhe një pyetje këtu: nuk e kuptova ndërtimin e sallës së teatrit, adaptimi. Unë me ndërtim e kuptoj prej zeros që ndertohet; adaptimin e kuptoj një objekt ekzistues. A do të jetë ndonjë objekt që do të adaptohet për sallë të teatrit, apo do të ndertohet prej fillimit? Edhe pse mendoj që ky nuk është investim prioritet për komunën e Vitisë, kur e dimë që nuk ka ndonjë grup teatror në komunën e Vitisë që funksionon, e ashut teatri nuk është duke funksionu as në Prishtinë, e lëre më në Viti. Kështu që kemi prioritete tjera që kishim mujtë me i destinu këto mjete.

z.Hajdin Ademi: Te puna e buxhetit po i shoh disa mangësi, si për shembull te përrocka dhe kanalizimi. Unë këtu te përrockat dhe kanalet nuk po e shoh fshatin **Skifteraj** që do të ketë ndonjë intervenim, por është ku i kemi tri kanale ku çdo vit kemi probleme, sidomos bujqit janë të dëmtuar shumë prej tyre. Kur ka reshje,

rregullisht shpërthejnë dhe dalin, i dëmtojnë bujqit. Kjo është urgjente që të intervenohet, dhe nuk po i shoh këtu në buxhet; kërkoj që të merren masa, të rregullohen këto, se bujqit kanë dëmtime me mijëra euro çdo vit.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Për mua është shqetësuese që janë 2.8 milionë investime kapitale, sepse me këtë shumë, veç një projekt serioz me pasë në komunë të Vitisë, nuk mundemi me kry. Por kjo është mundësia, kaq është buxheti që shkon; ne e dimë që 62% e buxhetit shkon në paga dhe mëditje. Ajo është dëmtimi kryesor që i bëhet buxhetit, se nuk ka mundësi me hy në investime kapitale, sepse kemi paga dhe mëditje pjesën më të madhe. Besoj që gjatë vitit do të ketë rimbursim të Qeverisë, sepse shumë komuna janë para bankrotit, dhe gjatë prezantimit po e shofim që një pjesë e projekteve janë 2-3 vjeçare, që ato veç janë vazhdimësi. Është mundi me u hapur një pjesë e projekteve me kode, që gjatë mundësisë së investimeve gjatë vitit, çdo investim që mund të bëhet, atëherë veç e ke kodin dhe mundësinë që në disa projekte me vazhdu. Kemi pasë një rekomandim të Kuvendit që është kërku asfaltimi i rrugës së UÇK-së, që është në prioritete dhe që është në buxhet, dhe janë disa gjera që janë diskutu. Edhe pjesa që diskutove, Hajdin, një pjesë e mirëmbajtjes shkon te shërbime mallra, që kanë kontrata që i lidhin drejtorët e Shërbimeve Publike, Inspeksionit etj. Këto dmth nuk hynë te investimet kapitale, por një pjesë e shërbimeve që intervenojnë gjatë kohës, dmth kanë kontrata tjera për mirëmbajtje të rrugës verore, dimërore – ato janë shërbime tjera.

zn.Melihate Ajeti, drejtoreshë: Znj. Elsa, për obligimet në total, pa u bërë fundi i nëntëmujorit, nuk na kanë dhënë hapësirë te thesari. E kemi këtë problem, por tjerat që i kemi pasur çdo vit janë të paraqitura edhe në pasqyrat financiare. Po krejt në fund, nuk mundemi me marrë derisa të na jep hapësirë thesari; kemi rënë dakord që nëntëmujorin e fundit, në moment që na jepet, do t'ia dërgoj edhe Jakupit edhe ty, Elsa. Sa janë mjetet në të gjitha projektet, i ke në material që e ke marrë para tri jave. Obligimet i nderuari Jakup, e njëjta është dhe përgjigjja për ty për sa i përket obligimeve. Krejt është e vërtetë që kemi thënë me pru listën, mirëpo pa u bërë nëntëmujorëshi, ajo që na e ka lëshuar me i nda ato sa i kemi te kompanitë dhe sa janë... por shumica janë edhe në procedura përmbaruese, që nuk na jepet hapësirë neve me i dhënë, përderisa na i dërgon thesari saktë. I kam kërkuar me na i nda, dhe na kanë premtuar që na ndajnë, mirëpo në nëntëmujorin e fundit. Lista e të gjitha obligimeve besoj se ka me u bë në fund dhe jua dërgojmë me shkrim, se nuk mundemi me i nda ne asnjë për atë arsye që e ceka edhe më lart. Edhe te pyetja e investimeve: nuk kemi mundësi me i zvoglu më shumë, për arsye se janë edhe kontrata që janë të lidhura 2-3 vjeçare, që e kemi me patjetër, nuk kemi mundësi me i zvoglu më shumë për me i qitë në mallra e shërbime apo diku tjetër. E kemi bërë të pamundurën aq sa kemi mujtë, se i kemi kontratat e lidhura dhe nuk kemi të drejtë me i ndërpre krejt mjetet e investimeve kapitale, përderisa i kemi kontratat e lidhura dhe duhet me i kalu për vitin 2027, që është me ligj obligim. Pse është zvoglu buxheti kaq shumë? Pyetja e Elhamit. Problem është që na është dashtë me bë një zvoglim në mallra dhe shërbime, siç e ceka më herët, dhe investimet kapitale, për arsye se kemi një rritje të 7 punëtorëve në arsim, dhe na është dashtë me bë një rotacion brenda për brenda për me mbulu mësimdhënësit edhe ato që janë zvoglu numri i punëtorëve. Në 18 milionë i kemi gjithsej. Po përgjigjem, ndërkohë edhe z.Ekremit: ne e kemi me patjetër me bë një rotacion brenda, me i zvoglu investimet kapitale, mallrat, shërbimet, me patjetër kemi pasë me mbulu grandin e arsimit, se është zvoglu grandi i arsimit kogja shumë. Dhe për mos me mbetë keq as te një mësimdhënës, as që ato provojat që kenë prej 0.25 në 0.5. D.m.th brenda për brenda buxhetit që kemi me 18 milionë, ne me patjetër është dashtë me bë zgjidhje dhe na është dashtë me i zvoglu të dy këto që janë më kryesore: te investimet kapitale që kemi mujtë, dhe te shërbimet, për me mbulu grandin e arsimit.

z.Labinot Bislimi: Ajo që sapo e tha drejtoresha, është dashtë me bë zgjidhje për çështjen e grandit të arsimit, i cili është më i vogël dhe nuk i mbulon tash pagat e mësimdhënësve. Në realitet, nuk është faji i drejtoreshës, e padiskutueshme, sepse kjo sot duhet me gjetë zgjidhje financiare qysh me i mbulu ato gjëra, por faji është i kryetarit, i cili për çdo fushë ka shti mësimdhënës të rinj në punë, duke e ditë qartësisht se ata nuk mundet me i mbulu, dhe kanë qenë tepricë. Sot janë afër 200 mësimdhënës të cilët nuk kanë nxënës të mjaftueshëm, krahasuar me atë kuotën që është nxënës-mësimdhënës. Siç e thashë më herët, jo se i kemi dhënë zgjidhje sot – drejtoresha e financave mundohet me i dhënë zgjidhje financiare, por problemi është politik; është klientelizmi i cili ka funksionu dhe vazhdon me funksionu, e që e ka dëmtu rëndë komunën e Vitisë, si në aspektin ekonomik, si në aspektin financiar. Kjo është vetëm pasoja e pare, vetëm pasojat e para jemi duke

i pa sot, por do t'i shohim dhe të tjerat që do të vijnë, të cilat i kam paralajmëruar së paku qe 4 vjet. Merrni shikoni statistikat e sistemit arsimor në Viti dhe e kuptoni qartë se ku jemi dhe çka ka me na ndodhë vitet e ardhshme apo vitet e ardshme. Merrni shikoni çerdhet. A e dini sa i ka punsu nëpër çerdhe vetëm si kuzhiniere kryetari jonë? Qysh po doni me ja dalë me financa, kur faktikisht ju i shtoni shpenzimet për të cilat po flas çdo seancë të kuvendit, dhe mendoni për mbrapa me i mbulu, me nxjerrë prej një kodi në tjetrin? Nuk mundemi me funksionu kështu, sepse buxheti duhet me reflektu realitetin ekzistues, dhe këtu në këtë rast buxheti nuk është duke e reflektuar realitetin ekzistues, por është duke u mundu me mbulu realitetin ekzistues.

z.Jakup Demiri: Drejtoreshë, arsyetimi apo përgjigjja që në nëntëmujor është i pakuptueshëm për mua, edhe nëse është i vërtetë, është i pakuptueshëm. Ne jemi duke folur qe një kohë të gjatë për këtë. Unë ashtu e kuptoj, kur nuk ka reagim prej anës suaj te arsyetimi mbi kontratën kolektive, që ta dimë, ta shohim listën, e shohim, e analizojmë dhe diskutojmë. Se këtu, sa herë të përmenden borxhet, thuhet: "Kontrata kolektive". Unë e kam një tabelë këtu: Komuna e Vitisë nuk ka qe 3-4 vjet planifikim të investimeve kapitale, edhe si pasojë e kësaj, komuna e Vitisë e ka problem. Unë e kam thënë shumë herë, dhe sikur të jenë këto probleme të vërteta në aspektin strukturor, buxheti i Vitisë ka problem. Po marr një shembull, e kemi potencu shumë herë, e ke pikën e 7, thotë: "Ndërtimi i hapësirave gjelbëruese publike në Viti janë 103 mijë e 630 euro". Ndali këto, se me investime kapitale është investim koti kjo punë. Veç një hapësirë gjelbëruese gjema ti në Komunë të Vitisë qe 10 vite që kemi investu, e që i ke sot funksionale. Ato nuk dihet që janë investu, se nuk shkohet te investime kapitale hapësirat gjelbëruese, se ato duhet me i mirëmbajt, duhet me i ujit, me pas perkujdesje, se ato thahen dhe kthehen në gjendjen e mëparshme; natyra e kthen habitatin e vetë ku nuk ka ndërhyrje. Shumë e thjeshtë është kjo punë. Kjo është strategji e komunës; shumë herë kam thënë: "Hekne prej këtuhi, qitne te shërbime dhe mallra". Përveç asaj që harxhojmë pare koti, ne po mbesim edhe pa hapësira gjelbëruese. Ne krejt mundemi me i kthy, mirëkohë kohën nuk mundemi me e kthye. Një dru dekorativ i duhet 10 vjet me u bë, pra, edhe me investu tash, duhet edhe 10 vjet. Po edhe nëse nuk e ndryshojmë tash, edhe 10 vjet e 100 vjet prapë kemi me mbetë pa hapësira gjelbëruese, e kjo është keqmenaxhim i parasë publike. Jemi duke folur për sene esenciale që janë, nuk ju shkon mendja se çka jeni duke bë. 103 mijë euro janë për 1 vit, ato kanë mjaftuar me ia dhënë dikujt, një operatori, se na e dimë edhe sa kushtojnë drutë në treg; qato drunj dekorativë, sa janë në përshkrim të paramasës: 25 euro kushtojnë në treg, aty i ki 80 euro në paramasë. Edhe këto sene janë... hajde, ato nuk mujmë, po hapësirën gjelbëruese ta kemi bile! I kemi 4 hapësira gjelbëruese në Smirë që janë investu që katër vitet e fundit: asnjëra nuk funksionon, sa di që ka pasur... bile muj me thënë që janë kthy në gjendje më të keqe, se po çojnë edhe mbeturina, po lanë tash aty njerëzit, është gjendja edhe më e keqe sesa ka qenë. Edhe njëherë: lista e investimeve kapitale nuk është kjo, edhe sikur sot të na vijë, asnjë projekt nuk ka që muj me fol. Ki këtu ndërtime, kontratë kolektive: "Shtegu i ecjes në Smirë", 25 mijë euro, po ki "Palestër sportive", 20 mijë euro. A e din? Kjo është me qeshë prej zorit! Një shteg i ecjes po kushtojka 25 mijë euro, edhe një palestër në shkollën e Smirës po kushtojka 20 mijë euro. Ky është buxheti ynë.

z.Visar Demiri: Punën e grantit të arsimit e mora vesh, edhe pse mendoj se e kam pasë ditur, por kësaj pune nuk mu përgjigj: te ndërtimi i sallës së teatrit tash, a do të ndertohet sallë e re e teatrit, a po do të adaptohet ndonjë sallë, a do të adaptohet ndonjë objekt ekzistues? Sallën e teatrit e kemi, por nuk kemi grup teatror, na kush me ba shfaqje? Edhe nuk di ndonjë komunë në Kosovë, përveç Prishtinës, që ka sallë të teatrit. Pse është parapa si prioritet në këtë kohë ndërtimi i sallës së teatrit në Viti, bash në këtë kohë që jemi në krizën më të madhe të projekteve? Pse me u ndërtu salla e teatrit e jo diku tjetër me i çu këto parë?

znj.Majlinda Shabani: As unë nuk mora përgjigje për sa u përket projekteve të investimeve kapitale: pse na kanë ardhur në këtë formë, pse janë vonuar? Edhe kisha pas dëshirë me e ditë, nënkryetari qenka këtu, drejtoresha: cilat janë projektet për vitin 2027? Projektet e reja. Këto përsëritjet që janë bërë në këtë listë që e keni sjellë, ju nuk po e di: a doni me e tregu këtë standardin tuaj që e keni krijuar, që çdo asfalt që shtrohet në komunën e Vitisë, brenda një viti mandej duhet me ndërhyrë në atë rrugë, duhet me u shtu prapë, me u prish e me u shtu prapë? Tash, çka jemi duke bë ne? Qato parë po i bjen që janë duke u keqpërdorë: shtro një asfalt, prish; shtro një rrugë rreth lumit Morava, prish, ndërhyrë prapë në atë rrugë; blloko sheshin, blloko qytetin, bëj eksperimente! Unë kisha pasur dëshirë shumë me ditë: cilat janë prioritetet për komunën e Vitisë? Vetëm tri i

përmendi, mandej për tjerat diskutojmë, sepse nuk ka asnjë analizë. Dëgjimet buxhetore që janë mbajtur. Unë po du me përmend, prej anës temë kam qenë shumë pjesëmarrëse sa u përket dëgjimeve buxhetore viteve paraprake si këshilltare, por vitet e fundit nuk kam qenë. E di me ta tregu arsyen pse nuk kam qenë: ato dëgjime buxhetore mbahen vetëm sa për sy e faqe, me e bë një foto, nuk merren parasysh diskutimet që bëhen në dëgjime buxhetore. Faktikisht nuk merren parasysh. Ka listë të kërkesave që unë i kam dorëzuar sa i përket fshatit Lubisht, dhe nuk kam marrë përgjigje pse nuk kanë hy në projekte ato. Madje, ajo çka ndodh në komunën e Vitisë, që shohim se ka projekte që realizohen e që nuk kanë qenë as të planifikuara, bëhen qaty për qashty, nuk ka një planifikim paraprak: pse një rrugë me shku me u shtru në një fshat, ndërsa në fshatin tjetër jo? Sa i përket ndriçimit, kanalizimit, trotuareve: nëse e merr e ekqyr trotuaret që i ki në Komunën e Vitisë, duke i përfshirë edhe fshatrat, i ki gjysmën të prishta, po flas prej fshatit që vij, Lubishtë: trotuari është jofunksional, dmth. trotuari që është shtru aty nuk i ka plotësu kriteret, standardin që është dasht me plotësu. E qetu e kemi problem, që për çdo vit vimë ankohemi që po kemi buxhet jo të mjaftueshëm për investime, kontratat kolektive, përmbaruesi, gjykata... edhe atë 1 milionëshin që e kemi, nuk dimë me e disponu ku duhet, nuk dimë me i dhënë kahje, edhe mundohemi me u trajtë haj medet... Dmth. sot me e dhënë një përgjigje konkrete: çka është duke ndodhur me këtë komunë, a din me tregu dikush ku ia keni mesy, a çka doni me ba? Është për keqardhje. Kisha pasë dëshirë me pasë kryetarin e komunës me na u përgjigj në pyetje.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në fillim e përshëndes vendimin e këtij kuvendi rreth deklaratës politike, besoj që kemi treguar një pjekuri jashtëzakonisht të madhe. Dhe natyrisht, shfrytëzoj rastin që Kuvendi i Republikës së Kosovës të merr shembull prej Kuvendit Komunal të Vitisë se si do të jemi bashkë kur bëhet fjalë për vlerat më themelore të këtij vendi. I nderuar Visar, salla e teatrit është duke u ndërtuar, është në proces e sipër te kompleksi i shkollës së mesme, te projekti me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe partnerët gjermanë. Po nuk do të jetë sallë ekskluzivisht për teatër, do të jetë sallë që do të shfrytëzohet edhe për aktivitete të tjera. Nevojat, dhe sidomos zvogëlimi i popullsisë, e kanë shprehë të arsyeshme që të kemi një sallë e cila do të jetë diku në 120 ulëse, shumë komode, e cila do të shfrytëzohet për aktivitete të ndryshme që do të mbahen në komunën e Vitisë, po në këtë rast edhe për aktivitete të teatrit. Kuvendi komunal e ka një vendim për themelimin e teatrit, dhe ne jemi duke punuar që në të ardhmen këtë iniciativë me e shty tutje.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ju falënderoj për unanimitetin që e patët rreth një deklarate që e patët shumë domethënëse për situatën politike në të cilën momentalisht gjendemi ne si Kosovë, po edhe ne si Viti që jemi të prekur nga kjo. Me keqardhje po e thamë që sot po bisedojmë për draftbuxhetin, që ndoshta as ekzekutivi, po as këshilltarët e Kuvendit Komunal nuk mujnë me e dhënë kontributin e vet në formën të cilën me ligj e kanë të garantuar. Ne mujmë ndoshta dy ditë me folë, tu ia lanë fajin njëri-tjetrit, por megjithatë një çështje duhet ta kemi të qartë: se burim ndoshta i krejt kësaj është një kontratë, e cila me të vërtetë na e ka prishur rrjedhën – duhet ta pranojmë këtë, dasht a pa dasht. Unë kam qenë në mesin e atyre që kam qenë edhe në dëgjime buxhetore, nëpër takimet të cilat i kemi pasë, po në fund edhe në përpilimin e këtij draftbuxheti, që me kryetarin e komunës e kemi thirrur komplet drejtorin e Buxhetit e Financave dhe zyrtarët, edhe kemi kërkuar në aspektin profesional ndihmë nga ata. E di pse i kam thirrë ata: se jam një prej atyre që nuk ka seancë të Kuvendit Komunal që kam mungu, dhe që nuk i kam marrë me seriozitet pyetjet të cilat i keni shtruar ju. Dhe konstatimi i zyrtarëve profesionalë nga drejtoria: ka kode të cilat aty nuk ki mujtë me ndërhyrë, për shkak se si kode të tilla janë të regjistruara në Ministri, dhe si të tilla duhet të kalojnë, për shkak se nga ato kode kemi dhe kontrata që krijojnë obligime financiare për komunë – është fjala te rrugët me zhavorr, asfaltim etj. E di që i kemi reduktuar disa, por këtu disa i kemi lënë për shkak se kemi obligime financiare ndaj operatorëve ekonomikë, dhe kemi kontratë të cilën e obligon komunën me e vazhdu dhe me i kry obligimet e veta të cilat i ka. Kur do të kryhen? Dhe unë pres që viti 2027 do të jetë shumë i rëndë. Formën, mënyrën se si jemi duke shkuar, konsideroj që në rast se nuk ndalet... sa të duash unë pajtohem kur thotë Labinoti: me pasë strategji, kot e bën strategjinë në rast se ti nuk ke pare. Nuk është problem veç i komunës sonë, po ne jemi të thirrur për komunën tonë. Në këtë gjendje, konsideroj që është pjesa dërrmuese e komunave tona; ju e dini që ka pasur një takim me Asociacionin e Komunave, ka pasur dhe një protestë për

këtë çështje, për shkak se nuk është problem kush më mirë e kush më pak. Ndoshta dikush i ka problemet më të vogla, por në tërësi i kanë këto probleme, dhe ky burim i kontratës kolektive tani sjell dhe probleme tjera me operatorët tjerë. Jakupi tha që 25 mijë euro i keni ndarë për një shteg të ecjes në Smirë, 20 mijë i keni ndarë për palestrën sportive. Shumë e logjikshme që nuk mundet me u rregullu me këto, por ka qenë edhe kërkesë e banorëve të Smirës, dhe është premtim i kryetarit që palestra në Smirë duhet me u ndërtu brenda mandatit. Me 20 mijë mundet me u hapë, me u lidhë kontrata; 25 mijë euro është... unë kam qenë aty së bashku me kryesuesin, të cilët kanë votuar, Smira për një shteg – nuk kemi mujtë me e rregullu këtë vit, për shkak se na i kanë marrë paret, ai na obligon, se është obligim! I kemi tubuar qytetarët aty, kanë votuar për një çështje të tillë, dhe duhet ta përsërisim derisa ta rregullojmë këtë. Prandaj janë disa çështje të cilat pa dëshirën tonë duhet me i përsërit, se obligimet... ti ke qenë prezent, nuk është me rëndësi a ki votu, a ki qenë prezent në atë takim. Unë gjithherë po thom: ishalla hasim në një mirëkuptim, jo si Komunë e Vitisë, po në nivel të Qeverisë, që edhe ata i dinë, si na që e dimë, borxhet që i kemi, dhe merret një vendim për rimbursim me 30% ose 40%, e dalim nga kjo situatë në vitin 2027 dhe fillojmë mbarë e mirë. Për ndryshe, projekte të reja, të cilat Majlinda tha... numrin e ke dhe qendrën e kulturës në Pozheran e ke, parkun e qytetit e ke, palestrën në Smirë – janë disa, por janë pak në raport me kërkesat dhe dëshirat të cilat kemi me i punu; shumica e tyre janë projekte të cilat janë në gjysmë, se ke kontrata të lidhura. Labinoti ngriti çështjen e arsimit: unë e di se janë disa komuna që e kanë gjendjen të mirë në raport me gjendjen financiare dhe numrin e nxënësve, si qytetet e mëdha; shumica e tyre kanë problem sikur ne. Vitia ka dhe komuna që kanë probleme edhe më shumë se ne, por unë besoj se kësaj çështjeje zgjidhje tjetër nuk i shoh, përveç zgjidhjes së mësimit të gjithëditor – ndryshe do të jetë problem, se numri i nxënësve në 2014 kemi qenë 11.600 nxënës, dhe tani jemi me 7 mijë nxënës diku. Dhe ky problem nuk është vetëm në Viti, duke i përjashtuar qytetet e mëdha si Prishtina, Fushë Kosova etj.

z.Labinot Bislimi: Nënkryetar, e di që nuk je duke e kuptuar diskursin tem, por është roli yt me mbulu të keqen – e ai e ka marrë këtë rol, të qoftë me shëndet! Për sa i përket asaj që the se "kështu e kemi buxhetin, se nuk kemi pare": e marr shembullin e fundit që ngriti Visari, ku tha se a na duhet teatri sot... por me thënë të drejtën, Visari dhashti me thënë a na duhet investimi për teatër sot, nuk e pati që me hedhë poshtë çështjen e teatrit si teatër. Nëse e shohim: Valmiri tha "jemi duke dashtë me ndërtu një sallë tek një shkollë, projekti 20 mijë euro është salla këtu". Shtëpia e kulturës. Nuk e di çka i duhet një teatër, pse duhet me ndërtu sallë të re? Teatër pa problem mundesh me bë këtë sallë të Shtëpisë së Kulturës këtu; mundesh me adaptu pak skenën, nuk e di çka i duhet një teatri më shumë sesa një sallë, spektatorët, biletat, sidomos një trupë teatrale! Unë mendoj se ne duhet me punu me ndërtu një trupë teatrale, se teatrin e ke... ja rasti konkret se si shpërdorohet një buxhet dhe krijohen shpenzime të reja të panevojshme. Folëm për punën e arsimit: unë e mbaj mend arsimin, se kam qenë në shkollë të mesme, kanë qenë me mijëra nxënës. Diku kah 2005 pati filluar edhe shkollimi i vajzave, pati filluar me u rritë numri i nxënësve; ky numër ka qenë më i madhi në komunën e Vitisë, dhe pastaj ka rãë kah 2013 – këto i kam studiuar. Unë kam shkruar edhe reformë të arsimit, dhe ju e dini se ajo reformë e arsimit pjesërisht u mor edhe prej Lumir Abdixhiku, i cili nuk e dike bash mirë, por i ra përrreth, se ai nuk e ka studiuar, e kam studiuar unë. Mirë the se 2013/14 kanë qenë diku 11 mijë e 600 nxënës, por ndërkohë kanë ikur prej vitit 2014/15 menjëherë ka pasur rënie drastike të nxënësve në Komunën e Vitisë. Nuk ka rënie në 2021/22 etj., por atëherë është... dmth. prej 2013 e deri më sot, çka ka ndërmarrë komuna e Vitisë për me e përmirësu gjendjen, për me i rirregullu politikat e saja në nivelin e sistemit arsimor, krahas me ta edhe ririadaptimin e buxhetit? Asnjë gjë hiq, përveç klientelizmit që e ka shtuar! Marrni numrin e profesorëve ose mësimdhënësve që keni pasur në 2005, dhe marrni sot keni me kuptuar se, atëherë i keni pasur diku 776, me 830 më duket janë sot, nuk po i di saktë shifrat, por përafërsisht dhe po t'i nyesh edhe ata që janë përkohësisht në sistemin arsimor. A e kuptoni që është rritur numri i mësimdhënësve, ndërkohë ka rënë numri i nxënësve? Dhe tani, në këtë projektbuxhet, ne kemi për me ndërtu palestrën në Smirë. Po për kë, në Smirë, se nuk ka nxënës? Apo për në Verban, se nuk ka nxënës. E kam thënë në këtë kuvend dhe e kam shkruar në reformë, se QMF-të apo AMF-të ne duhet me i shndërruar në çerdhe; ju keni shkuar me ndërtu çerdhe të reja! A e dini sa hapësirë publike është e pashfrytëzuar në Komunën e Vitisë, dhe ne jemi duke ndërtuar hapësira të reja në Komunën e Vitisë? E knej po thu që "kaq e kemi buxhetin, po kaq"... Po si je duke e shfrytëzuar, se unë jam duke e ditur që nuk

jemi duke folur për buxhetin e Nju Jorkut. Nuk jemi jashtë; ti je jashtë, nënkryetar, që po mundohesh me mbulu realitetin i cili nuk përputhet me buxhetin këtu.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Labinot, më quajte se e ke marrë përsipër me mbulu të keqen. Unë konsideroj se kurrë jo, por megjithatë nuk e kam ndërmend me ta ndryshu mendimin tende. The se unë kam bë studim për reformën në arsim – ti e ke bë, por e ke bë si qytetar, si kandidat për kryetar komune. Unë e di se 4-5 kandidatë sa kanë qenë për kryetar komune, të gjithë keni pasë programet e juaja, keni konkuruar, dhe në contest të saj është pranu një program, një strategji e kryetarit i cili është i zgjedhur tash momentalisht. Thua te numri i personelit arsimor: dakord jam se ndoshta ka pasë personel më pak, e tash ka më shumë, veç duhesh me pranu një çështje, se tash e ke funksionalitetin e dy çerdheve të cilat bëjnë pjesë në kuadër të punëtorëve arsimorë, e ke edhe në Drobesh e Çifllak. Nuk ka punëtor që merret ndesh në arsim, ndesh shërbim civil, ndesh shëndetësi, që nuk bëhet kërkesa dhe aprovimi nga ana e ministrisë, dhe krejt këto çështje janë bërë në këto forma, në aspekt ligjor janë bërë në mënyrë të koordinuar.

z.Jakup Demiri: Nënkryetar, edhepse për dy pyetje nuk mu përgjigje hiq: është çështja e investimeve të ndërtimit të hapësirave gjelbëruese, mendoni vetë se ku jemi me ato investime dhe a duhet me vazhdu në këtë formë? Edhe tjetra: te raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Të njëjtën ditë apo të nesërmen, që e ke shtru këtë temë në KPF, e kam formuar me vendim grupin për hartimin e planit të veprimit për me ardhur në Kuvend. Pse janë vonuar? Tash, njëri në pushim vjetor është çështje tjetër; ti e din që nuk vjen raporti, por plani i veprimit. Cilat janë planet të cilat do të ndërmerren prej ekzekutivit për tejkalimin e të gjeturave nga ana e raportit.

z.Jakup Demiri: Jo, nënkryetar, unë e kam lexuar raportin, por është obligim ligjor me pru në Kuvend, se kjo punë tani nuk ka peshë. Nënkryetar, unë thashë tjetër sen, por në fakt thelbi ishte tjetër sen i shtegut të ecjes dhe i palestrës. Unë e bëra krahasimin e investimit, se nuk është puna projektit të shtegut të ecjes mos me bë atë e me bë këtë, por palestra në Smirë është muhabet, folim drejtë, se ajo nuk ka me u ndërtu, nuk ka vend, ajo është me i qitë hi syve, projekt që nuk bëhet. Po flasim për një diçka që e dëgjova, dmth. projekti duhet të jetë financiarisht i përballueshem, jo veç me qitë projektin. E kemi palestrën në Drobesh që 10 vjet po i bënë, kujna dojmë me ia maru? Ne po bajmë aq shumë projekte, e disa i kemi të pashfrytëzuara, dhe ata kërkojnë mirëmbajtje; besoj që edhe 2-3 vite këto investimet kapitale nuk kan me na dalë vetëm për mirëmbajtje. Ndërsa investimet e planifikuara në Buxhetin e Komunës së Vitisë, krahasuar me investimet që bëhen në fushata, janë diametralisht të kundërta. Bile po tregoj: më shumë investohet në fushata, se për 4 vjet, po flas tani për Smirë, i ki 3 rrugë private, është bërë investim natën e zgjedhjeve, edhe një rrugë te vorret nalt te shtëpia e lagjes që thirret, por as nuk janë të planifikuara, as të parapame. Kjo është ajo klientelizmi, psh. ai që ka nevojë për arsim, vjen në punë për votë, e tash fiton ai programi i arsimit. Edhe pa ekzistuar hiq programi i arsimit në fushata fiton! Pse? Se po vjen rruga te shtëpia, po more ta bijë. I shtrohen 300 metra rrugë asfalt, 2 njerëz jetojnë aty në Smirë, po të them e ke, janë 3 shtëpi, shtohen 700 metra rrugë, në njërën prej rrugëve nuk janë, më duket, as 7 banorë – janë shtru 300 metra asphalt. Këto kanë ndodhur natën e zgjedhjeve. Dhe për atë fiton edhe ai programi që nuk është i shkruar hiq, i arsimit apo i shkollave, kjo është ajo puna e zgjedhjeve. Ndërsa investime në Smirë ki më shumë për 1 javë fushate sesa komplet 4 vitet që kanë shkuar, këtë edhe si mjet financiar, kaq pare janë të investuara. Më dhimbset, se qetu unë nuk mund të planifikoj kurgja hiq. Unë e kam një lum në Smirë që kundërmon tërë verën, e që 10 vjet e kemi dorëzu me na e pastru Komuna e Vitisë, kurrë as që e diskuton. Kundërmon, përhap sëmundje, dhe as që diskutohet! Qaj është prioritet i banorëve të Smirës, të fshatit temë, nuk po du me përmend Smirën, po po lidhem se i di konkretisht, se ne jemi asambleistë të Kuvendit Komunal dhe duhet me i mbrojtur parimet e të gjithë territorit të Komunës së Vitisë. Po, po du me thënë që prioritetet në lokalitete as që përfillen hiq. Këtu është Buxheti i Komunës së Vitisë. Përdoret aty ku ka votë edhe ku ka najkujt që i shkon muhabeti. Unë jam mësuar me këtë, po du me thënë but, se Labi e tha më egër: jeni bërë jorgan i asaj që nuk duhet, më vjen keq.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Jakup, realiteti kosovar, që në mesin e tyre ke qenë edhe ti aty, nuk përjashtohet mundësia që në ditën e zgjedhjeve nuk bëhen më shumë se... Në mesin e tyre e ki bë edhe ti bre kyçjen në Gërlicë, në territorin e jashtë Komunës së Vitisë, keni dalë edhe ju, nuk të kam thanë kurgja.

z.Jakup Demiri: Nënkryetar, kyçja ka shkuar me prokurim, këto nuk janë me prokurim, mos bë kësi krahasime! Këtu ki punu pa procedura të prokurimit, as nuk janë kanë të parapame.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Tash po më shti me dyshu se daljen prej autostradës jeni tu e prit me bë edhe kur të bëhen zgjedhjet tjera, po më shtin me dyshu se me pas qenë në zyrë të prokurimit, si e keni bë kyçjen e kishi bë edhe shkyçjen, po nuk e keni bë! Në prokurim e kemi pas, shtrirja e rrugëve që e kanë kodin aty, e parapame është.

z.Jakup Demiri: Smira e ka një këshill të fshatit, që e kanë një listë të dorëzuar me prioritete, e tash është një projekt... që na vuajmë prej një projekti edhe nuk e marr parasysh kush. Aty te lumi vuajmë, kundërmon, dhe sa është në gjendje me u shtu – së paku me pastru aty duhet me u intervenu, e komuna shkon shtron asfalte në rrugë private.

z.Elham Emërllahu: Po mendoj që Jakupi dhe nënkryetari e ulën debatin me krahasime, por realisht pajtohem me atë që e tha Labi. Ne jemi duke folur për çka në vitin 2027 e 2028, 2029, as reforma në arsim, as në sektorët e tjerë nuk mund të bëhen për një vit, dy e tri; reduktimi i stafit të mësimdhënësve etj., etj. Ne të gjithë po e dimë se shumica e buxhetit paraprak shkon për arsim, sepse është qai numri i mësimdhënësve. Është tash, nuk muj me... nëse nuk fillon një projekt, se çka pas 4 vitesh është pak vështirë me diskutu, prandaj duhet me u thirr në bazë. Cila është baza? Unë i bëra në fillim pyetje drejtoreshes, sepse edhe tek grandi qeveritar Komuna e Vitisë, në bazë të projektimeve që janë bërë në arsim, ka me pasë telashe në vitin e ardhshëm në mbulimin e numrit të mësimdhënësve! Edhe bëra pyetje: pse është buxheti më i vogël 60 e sa mijë euro për vitin e ardhshëm? Ne në seancën e kaluar e kemi miratuar të hyrat vetanake për gjashtëmujorin e parë, edhe e kemi pa që edhe të hyrat kanë çaluar, janë më pak se sa vitin e kaluar për gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Këtu është tema! Nëse neve na rriten shpenzimet për arsim edhe nuk rritet buxheti për vitin 2027, çka kemi me mujtë me ba? Duhet me i marrë do pare te shpenzimet kapitale, te mallrat dhe shërbimet, me i mbulu në arsim edhe në resorë të tjerë. Këtu është problemi im! Unë nuk jam ekonomist, po pse nuk është rritë buxheti, a është problemi te niveli qendror, te grandi qeveritar, a po te të hyrat komunale? Se për ndryshe, ne vetëm kemi me u zi kështu edhe vitin e ardhshëm.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Faleminderit nga të gjithë! Përcaktimi i buxhetit, vlera e buxhetit përcaktohet me parametër, me formulë prej nivelit qendror, edhe të hyrat vetanake: ti mundesh me i mbledh më shumë, po këto të hyra t'i përcakton ministria, sa i ki të hyrat, sa grande. Të gjitha këto shkojnë me formulë që kanë për të gjitha komunat. Ndërsa projektet që i miraton Qeveria me buxhet të Kosovës mund të jenë projekte jashtë këtuhit, ata vijnë prej ministrisë si projekt, si buxhet i komunës së Vitisë përmes formulës që i takon nga niveli qendror; ky buxhet miratohet nga Kuvendi Komunal, shkon në Ligjin e Buxhetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e Kuvendi i Kosovës e miraton buxhetin, e kur ta miraton, ky buxhet kalon në ligj.

z.Elham Emërllahu: Kryesues, Qeveria nuk mundet me ta parapa që këtë vit ti t'i kesh të hyrat vetanake 60 mijë euro më pak se vitin 2025.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Qeveria nuk ta ndalon me mbledhë më shumë, komunat mundet me mbledhë më shumë, mirë po si planifikim e ka leju këtë ministria.

z.Ekerm Abazi: Sa i përket projekteve nëpër fshatra: aty këtu janë vetëm në letër; aty ku individi i një fshati ka lidhje me kryetarin dhe ekipin e vet, ai projekt edhe mos me qenë këtu hiq, ai kalon. E ai që nuk ka lidhje me kryetarin, ai shtyhet 2, 3, 4 vite. Por edhe pse ky buxhet është aq i vogël, unë dyshoj që edhe kaq buxhet i vogël që është për investime kapitale, ky keqpërdoret.

z.Jakup Demiri: Elhami, s'e di se për çka e ula nivelin e muhabetit këtu, kisha pasë dëshirë me ma sqaru!

z.Elham Emërllahu: Sepse nënkryetari u kap te autostrata që nuk pajtohem. Nuk duhet me e lidhë asi paralele. Dorën në zemër, masi po bëhemi kaq lokalista, vallai në Smirë ishte shtru kogja shumë asfalt, ishte bë rreth e rreth zi deri te varrezat e reja atje, e mu sill, kur po kthehemi. Në Verban, për katër vite nuk është shtru asnjë rrugë, e tash po e shof që vetëm me zhavorr paska me u shtru diçka, e nuk e di ku është ajo rrugë në Verban.

z.Jakup Demiri: Elhami, për rrugët që janë shtru në Smirë, ato rrugë që janë shtru në Smirë, vetëm një, se tjerat nuk ki mundësi me i pa, sepse janë në oborre, janë dyer të mbyllura, nuk mundesh me i pa. E për këto

tjerat i ka shtru fshati vetë, rrugët e fshatit, katuni jonë i ka shtru; rrugën kryesore e ka shtru qeveria në vitin 2006 ose 2007. E për investime në Smirë, janë do fshatra që nuk janë as sa një lagje e Smirës, e kanë investime më shumë në këto fshatra sesa për katër vite në Smirë. E Smira është taksapaguesi i dytë në Komunën e Vitisë, e ato që janë investu natën e zgjedhjeve është problem, se nuk e di si kanë me i mbulu me letra, ato as nuk kanë kalu nga Zyra e Prokurimit.

z.Bekim Azizi, kryesus i Kuvendit: Ju faleminderit për kontributin e dhënë! I kuptojmë të gjitha rrethanat, obligimet që janë. Shumë sinqerisht po ju thamë: është një vit që ka me qenë shumë i rëndë buxhetor për Komunën e Vitisë për shkak të obligimeve që i ka komuna. Me u kan' të realizohen këto projekte që janë në letër, na kishim me qenë shumë të gëzuar, por për shkak të obligimeve kemi me pasë jashtëzakonisht telashe. Prej këtu shfrytëzoj rastin që Qeveria t'i ndihmojë komunat që vitin e ardhshëm të dalin nga kriza, sepse komunat jashtëzakonisht rëndë janë me pozitat financiare. Dhe kërkoj miratim të këtij buxheti. Kush është që të miratohet buxheti, me ngritje dore? Kush është për? 15 vota për, 5 vota kundër, 2 abstenime, miratohet buxheti komunal.

Si pikë e katër e rendit të ditë:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-110/05-490, të datës 04.05.2026, për kthimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Në muajin mars e kemi votu një vendim për ndarjen e mjeteve buxhetore; ka qenë për DEMOS, investimet që i ka pasë në sheshe, ato mjete i ka marrë përmbaruesi, e ne kemi marrë vendim prej një kodi buxhetor. E kanë kthy që është vendimi jo i ligjshëm. Tash duhet me e shfuqizu. Hapi debat! Pasi që nuk ka për debat, e qes në votim. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim, kalon edhe kjo pikë.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e raportit për vlerësimin e dëmëve të shkaktuara në Komunën e Vitisë

I kemi dy raportet e bujqësisë, sot ju ka ardhur edhe i ekonomisë, sepse komisioni nuk ka mujtë me e përgatit raportin për dëme në ekonomi; është fjala për dëmet e para, dëmet e dyta nuk janë vlerësu ende. Unë ia jap fjalën drejtorit.

z.Naim Pira, drejtor: Faleminderit, kryesues! Me lejoni që t'ju përshëndes juve dhe të gjithë që janë prezentë. Ju e dini që këtë vit jemi ballafaquar me një vit jashtëzakonisht të rëndë për fermerët e komunës së Vitisë, po edhe për bashkësitë familjare. Kemi pasur dëme të konsiderueshme për shkak të fatkeqësive të ndryshme elementare, e në veçanti për shkak të erërave të forta dhe për shkak të breshërit që ka qenë këtë vit. Komisioni është formuar nga zyra e kryetarit, komisioni e ka bë punën e vet, për çka i falënderoj sepse kanë bë një punë të jashtëzakonshme. Materialin e kemi marrë; kërkoj që të miratohet ky raport. Për pyetje shtesë jam në dispozicion!

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë!

z.Elham Emërllahu: Kam diskutu shumë javëve të fundit, jam marrë pak më shumë me temën e dëmeve, sidomos në sektorin e bujqësisë, por tash kur erdhi edhe ky raporti tjetër për dëmet e bizneseve, familjeve, të jep me kuptu që komuna e Vitisë asnjëherë nuk ka qenë më e dëmtume se kësaj here. Unë edhe seancën e kaluar e kam ngritë si problem, se i kemi pa krejt dëmet që janë shkaktu, veç unë po du me e falënderu publikisht komisionin komunal, i cili ka bë një punë të jashtëzakonshme, sepse nuk është lehtë me i evidentu këto dëme, këto kërkesa për vlerësim të dëmeve që janë bërë edhe nga bujqit, fermerët, qytetarët, bizneset. Problematika këtu është që kam pasë një takim me drejtorin e bujqësisë edhe kam thënë: cilat janë masat që ne, edhe si Kuvend Komunal edhe si ekzekutiv, që me e sensibilizu sa më shumë problemin e kompensimit të këtyre dëmeve, sepse janë dëme shumë të mëdha, aq të mëdha janë për disa bujq sa që ka me pas shumë të pamundur që vitin e ardhshëm me operu në veprimtarinë e tyre. E tha edhe drejtori, po e përsëris edhe unë,

është fakt: nuk mundemi me i ikë, nuk ka nevojë me bë politikë, nuk janë kompensuar dëmet as 3 vitet e kaluara. Po këtu, sidomos për këta të bujqësisë, i kisha lutur të gjithë që me i destinu në vendin e duhur, drejtor, sepse ka pasë zëra që ka pasë defekte, gjoja se ku janë dërgu raportet e vlerësimit të dëmeve. Kisha kërkuar edhe prej drejtorisë edhe prej komunës që të paktën proceduralisht të dërgohen në vendin e duhur këto dëme. Unë kam parë edhe komunat e tjera që kanë ngritë shqetësimin për kompensimin e dëmeve, por neve na intereson për komunën tonë, sepse jemi regjion bujqësor. Prandej, ky dëm për disa bujq të Skifterajt sidomos është i papërballueshëm për vitet e ardhshme që ata me u marrë me bujqësi. Kapacitetet komunale ne po i dime, edhe këtë vit edhe vitet e ardhshme kanë me qenë të njëjta, në bujqësi shumë vështirë! Prandej kisha kërkuar që të gjithë me bë të pamundurën që me e ngrit sa më lartë problemin e kompensimit të këtyre dëmeve, sepse nuk është hajgare, nuk është politikë; askush nuk ka ardhur këtu me raportu për me përfitu diçka, gjithsecili prej atyre, sidomos për bujqit po flas, që kanë ardhur, kanë raportu dhe që komisioni e ka vlerësu, janë të dëmtuar realisht.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Orientimisht, adresë tjetër nuk ka pos Kuvendi me e miratu raportin. Komisionin e falënderoj për vlerësimin që e kanë bërë; të gjitha kërkesat që janë bërë prej qytetarëve e kanë pasur për detyrë me i vlerësu komisioni.

z.Elham Emërllahu: Ka pasë zëra që nuk janë dërgu në adresë të duhur, nuk janë përpilu mirë raportet. Unë e falënderoj publikisht komisionin që kanë bërë një punë të madhe, po ne duhet me e çu në adresë të duhur, e mandej në aspektin institucional, edhe si përfaqësues të qytetarëve, me e ngrit zërin që duhet me u kompensu!

z.Nuhi Ramadani: Unë mendoj se miratimi i këtij raporti është i rëndësishëm për bujqit, por njëkohësisht duhet të mendojmë edhe për mbështetje konkrete të fermerëve. Tani jemi në kohën e mbjelljeve vjeshtore; bujqit kanë nevojë më shumë se kurrë. Kosta e shpenzimeve janë rritur ndjeshëm: nafta është afër 2 eurove, plehu artificial 64 centë për 1 kilogram, fara 53 centë për kilogram. Ne duhet t'i ndihmojmë bujqve, sepse ku janë dhe shërbimet tjera? Prandaj kërkoj që fermerët e dëmtuar nga breshëri mos të mbesin vetëm me një raport në letër, por të kenë mbështetje konkrete në kohën e duhur, se çdo vështirësi edhe më shumë e vështirëson gjendjen e tyre.

z.Jakup Demiri: Pa dashë me ataku drejtorin, por kur të ka këso gjërash është mirë komisioni të ketë edhe anëtar të opozitës. Nuk është në rregull kjo punë, nuk është që nuk po i besoj, por është e rrugës që të ketë edhe anëtar nga opozita. Dhe tjetra është që raporti i fermerëve të kishte me qenë i ndarë prej raportit të bizneseve, dhe të ketë të dhëna pak më shumë, pasi që nuk kemi qenë në komision ne me dijtë. Se e pashë që përfituesi më i madh është një njeri që është më i fuqishëm në aspekt ekonomik në Komunën e Vitisë – Pro&Co Group. E tash e di që si të dal jashtë, munden me thanë: "E po ky është kryetar i komunës", se ashtu e cilësojnë, edhe i qeverisë, po e pranoj unë! Komisioni është mirë me këto që janë të gjendjeve të jashtëzakonshme me pasë dhe anëtar të opozitës, se nuk është keq.

z.Basri Aliu: Lidhur me dëmet në bujqësi dhe ekonomi familjare, komisioni i cili ka qenë i formuar prej komunës e ka bë një punë të jashtëzakonshme, sidomos këta të bujqësisë, sepse në këto tabela paraqiten të detajuar edhe cilat bereqete kanë pasë dëme dhe me çfarë përqindje. Prandaj unë e vlerësoj komisionin, edhepse në kohën kur këta kanë punu, kanë pasë edhe aplikimin e komisionit, domethënë që koha ka qenë e ngushtë, por kanë bërë punë të mirë! Por besoj që këto dëme të realizohen nga buxheti i cili është i ndamë për dëme emergjente. Dhe po e shfrytëzoj rastin ta njoftoj edhe kolegun që në vitin 2024–2025 kur i kemi dërgu dëmet të cilat janë bërë, nuk është e vërtetë që nuk kanë shkuar në adresë të duhur, por kanë shkuar aty ku duhet, sepse vet unë kam komunikuar me kryetarin e komisionit për caktimin e dëmeve emergjente që është në kuadër të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, aty kanë shkuar, por pse nuk janë pagu, aty është diçka tjetër. Shpresoj se kësaj radhe Qeveria do të ketë parasysh, sepse me të vërtetë bujqit janë dëmtuar shumë.

z.Naim Pira, drejtor: Pa dashë me polemizu me askënd, kishte me qenë e mirëseardhur që në kuadër të komisionit me qenë kushdo qoftë, se nuk e pengon askënd, por është një rregullore që e përcakton, Rregullorja Nr.17/2025, që e përcakton edhe profilin e komisionit, i cili duhet me qenë në vlerësimin e dëmeve. Sa i përket asaj që tha Elhami: komisioni i formum nga angazhimet e drejtorit të bujqësisë ka punu për secilin fermer veç e veç, dhe kemi në procesverbal për secilin fermer veç e veç kulturat të cilat janë dëmtu, përqindjen me të cilën

janë dëmtu, dhe ia kemi dërgu ministrisë. Janë 3 - 4 raporte këtu; është një punë shumë voluminoze. Është e vërtetë që ata kanë dhënë ndonjëherë ndonjë vërejtje, sepse njeriu nuk mundet me qenë i përkryer, mund të bëjë gabime, por gabimet i kanë përmirësu menjëherë komisioni. Edhe unë kam qenë prezent herën e fundit me njërin nga anëtarët e komisionit, në këtë rast ka qenë Avni Misini që e kemi dërgu në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave raportin e fundit, dhe sot ai raport nuk ka pasë vërejtje dhe është procedu për pagesë. Por fatkeqësisht po e them edhe një herë që 3 vitet e mëhershme dhe tani ky vit, domethënë viti i katër, që nuk është kompensuar ende askush, jo vetëm për fermerët e Komunës së Vitisë, por të gjithë territorit të Republikës së Kosovës. Unë po apeloj te organet kompetente që merren me vlerësimin e kompensimin e dëmeve, që siç e tha edhe këshilltari, është një vit i vështirë me çmime marramendëse të ngritura, dhe do ta kenë problem fermerët kësaj vere t'i kryejnë mbjelljet e tyre që kanë planifikuar. Po apeloj që ta gjejnë mundësinë që t'i kompensojnë, se janë në një gjendje të vështirë. 1.5 milion euro Komuna e Vitisë veç këtë vit ka dëme, është një shumë marramendëse. 138 kërkesa nga bujqit na kanë ardhur dhe vetëm 10 janë të refuzuar, se ka qenë vlera e dëmeve 20 euro dhe nuk ka pasë arsye të vlerësohet. Po pajtohem me Elhamin: t'i bëjmë përpjekje ta shtojmë ndikimin aty ku kemi mundësi, në mënyrë që t'u kompenzohen këto dëme bujqve aq sa ka mundësi.

z.Hajdin Ademi: Unë veç dashta ta falënderoj komisionin për punën e tyre që kanë bërë, dhe kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të kompenzohen bujqit dhe qytetarët e Komunës së Vitisë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Dhe një herë po them që, pjesa e dëmeve që ka qenë pjesa e dytë e fatkeqësive natyrore nuk janë të vlerësuara ende, për shkak mos me u vonu në procedurë të pjesës së parë. Pra, e qes në votim. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pike. Pra, shkojmë me pauzë, shihemi në ora 13:30. Pasi që kemi kuorum, vazhdojmë me seancën pas pauzës.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për vënie në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026-2034

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sot para jush po e prezantoj informatën për përfundimin e vitit shkollor dhe përgatitjet që kemi bërë për fillimin e vitit shkollor 2026–2027. Fillimisht theksoj se viti 2025–2026 ka përfunduar me kohë, sipas kalendarit të MASH-it [dhe tani një sqarim: prej tani e tutje nuk është MASHTI, por veç MASH]. Ka qenë një vit i mbarë dhe i organizuar mirë, dhe sipas planifikimeve, gjatë këtij viti kemi pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm me drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit, me qëllim që procesi edukativo-arsimor të zhvillohet sa më mirë. Gjatë këtij viti kemi pasur edhe shumë sfida, por njëkohësisht kemi pasur edhe shumë aktivitete dhe rezultate pozitive. Për mësimdhënësit janë organizuar trajnime dhe aktivitete profesionale, ndërsa kemi vazhduar bashkëpunimin edhe me Policinë e Kosovës, veçanërisht me aktivitete vetëdijesuese. Që të mos ju marr kohë më shumë – materialin e keni marrë me kohë – për çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj!

z.Elham Emërllahu: E nderuar drejtoreshë, paraprakisht i uroj të gjithë mësimdhënësit dhe stafin arsimor për fillimin e vitit të ri shkollor! Shpresoj dhe uroj që ky vit me qenë më i mirë se viti i kaluar. Për mua, si asamblist dhe mësimdhënës për një kohë të gjatë – duke i marrë parasysh krejt këto që i tha drejtoresha, vështirësitë financiare – por kur të bëhet raporti i punës, ta zëmë, ose i vitit shkollor, është mirë ndonjëherë me i përmend edhe defektet dhe humbjet që i ka pasë ekzekutivi, sidomos gjatë vitit shkollor 2025–2026. Ndoshta jo krejt fajin e drejtorisë, por gjithë jemi dëshmitarë që vitin e kaluar konkurset për pranimin e mësimdhënësve të rinj kanë çaluar shumë dhe janë anuluar dy-tri herë nëse nuk gaboj, dhe gjatë asaj periudhe ka pasë mungesë të mësimdhënësve për orët mësimore, dhe si rezultat i saj ka qenë një humbje diku prej 7 mijë orëve për vitin 2025–2026, që janë shumë për Komunën e Vitisë. Para disa muajve kam pasë një diskutim në Kuvendin Komunal për disa çështje të cilat duhet t'i ndërmarrë Drejtoria Komunale e Arsimit. Unë e kuptoj që është njëra prej drejtorive që ka staf të madh të punëtorëve, mësimdhënës, mbështetës etj., por personeli në Drejtorinë Komunale të Arsimit është shumë i vogël, edhe unë e di që aty në drejtori është një ekip i mirë e që punojnë shumë, por që unë kam thënë vazhdimisht dhe po e përsëris që Drejtoria e Arsimit ka nevojë edhe për staf

tjetër administrativ në kuadër të saj, në mënyrë që me i menaxhu sa më mirë punët, problemet dhe sfidat me të cilat përballemi. Janë përsëritur në vazhdimësi dy-tri vitet e fundit. Unë, si mësimdhënës që kam qenë e që ende jam, e di se këto nuk kushtojnë shumë kosto financiare, vetëm se duhet përmes prokurimit, tenderëve, sidomos puna e mirëmbajtjes së nyjeve sanitare e pastërtisë, që para disa javësh ka dalë dhe në publik, shkolla e Madhe, aty ka qenë problem, se kam punuar aty e di! Problemet në pastërti, në higjienë, në mjetet e punës, në mjete të konkretizimit, në digjitalizim, në printer, në toner, në fotokopje, në letër – mësimdhënësit i kanë pasur dy-tri vitet e fundit shumë problem. Tash kjo kurrikula jonë e arsimit cila është në fuqi i parashikon aktivitete të ndryshme të mësimdhënësve me nxënës, dhe natyrisht që duhen mjete. Ka pasur raste ku në shkollën ku unë punoj, shpesh mësimdhënësit kanë mbledhur mjete me ble toner për printer, sepse nuk ka pasur ngjyrë, dhe është shumë vështirë! Ka teste periodike të nxënësve, të arsimtarëve, mësimdhënësve, që një mësimdhënës mund të ketë edhe 300–400 nxënës, dhe ai është i detyruar me gjetë forma tjera për me e fotokopju një test. Por mbi të gjitha ka qenë dhe është shqetësim në shumicën e shkollave mirëmbajtja e shkollave. Ka pasur probleme edhe në shkollën ku unë punoj: me punëtorët teknikë, me zëvendësime, në pushime mjekësore. Edhe e kam thënë edhe atëherë: nuk e di a ka ndonjë kompani komuna për mirëmbajtje, që herë pas herë me dërgu ndonjë kompani për mirëmbajtje në mënyrë që ato nyje sanitare, ajo pastërti, të mirëmbahen pak më mirë? Unë e pashë edhe drejtoreshën që paska qenë në komunën San Julian, e paska vizituar një shkollë, dhe hapi i parë i një shkolle ku shihet mënyra se si funksionon arsimi është edhe mirëmbajtja. Unë kam thënë edhe atëherë që komuna e Vitisë nuk ka nevojë më shumë për ndërtime e për fasadime e ngjyrosje të shkollave në hapësira të jashtme, sepse janë kryer shumë edhe me projekte të vitit të kaluar, edhe nga qeveria, e me grante të ndryshme. Prandaj duhet të mendohet më shumë në mirëmbajtjen e brendshme dhe sigurim të kushteve që mësimdhënësit me pasë mundësi me i kryer punët dhe detyrat e tyre të cilat iu takojnë. Pra, pse mos me mendu. E kam thënë edhe para katër-pesë muajve këtu, pse mos me mendu që në katër vitet e ardhshme që Komuna e Vitisë me siguru edhe tabela digjitale për mësimdhënës? Disa shkolla i kanë, po janë kryesisht donacione. Edhe me hartu një plan – nuk e di me krejt paralelet sa shkolla janë në komunën e Vitisë, po më duket që janë 24–25, nuk ka më shumë edhe fotokopje me pasë, ngjyra, printer. Shumë shqetësuese është puna e tyre. Kur të bëhet raporti, me gjithë respektin, është mirë nganjëherë me i përmend edhe defektet edhe dështimet, jo vetëm me thanë "për shkak të mundësive buxhetore". Unë kam thënë edhe para 5–6 muajve se është mirë me u hartu një plan ose një strategji për arsim në komunën tonë, e në kuadër të saj me u parapa edhe këto defekte që i thashë. Ne nuk mundemi me dalë në strategji nëse e hartojmë jashtë kurrikulës dhe jashtë udhëzimit administrativ, por me i parapa qeto që unë po i thamë.

z.Ilir Zuka: Po du me e falënderu drejtorin e arsimit, po lidhem me shkollat e Pozharanit, t'i përgëzoj dy drejtorët që janë tu e majt shkollat në mënyrën më perfekte të mundshme. Nese doni me pa çka është pastërtia, ejani në dy shkollat e Pozharanit si mbahen shkollat. Po aty është një problem tjetër: mësimdhënësit kanë problem me prindër, për shkak se i futin veturat në oborr të shkollës, edhe oborri është shumë i vogël ku po vijnë me i marrë nxënësit ose anasjelltas. Kështu që është shumë rrezik për këta nxënës, me pasë mundësi mos me i leju! Ne e kemi qitë shenjën e komunikacionit, po ata prapë hin me vetura në oborr të shkollës.

z.Jakup Demiri: Drejtoreshë, i kam tri pyetje rreth drejtorisë suaj. Njëra ka të bëjë me objektet të cilat vitin e kaluar kanë pikë shiju, ka depërtuar uji në klasa. A janë evituar këto dhe a janë në gjendje teknike për me u zhvillu procesi arsimor? Pyetja e dytë: e kanë një shqetësim qytetarët që ma kanë thënë, besoj që edhe juve ju kanë thënë, vërehet një numër i madh i nxënësve nëpër kafe ose në qytet, ku gjatë orarit të mësimit nuk janë në shkollë. A keni mbajtur ndonjë takim me drejtorët e shkollave për këtë problem? Dhe pyetja e tretë është: a janë të përgatitura për procesin e mësimit të gjitha gjatë dimrit, a janë siguruar drutë aty ku duhet, për shkak se tash po keni problem me çështjen e buxhetit, a është i zgjidhur ky problem?

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje! Konkursi i rregullë për rekrutimin e mësimdhënësve – sa konkurse të rregullta kanë qenë këtë vit, tash në muajin gusht ose shtator? Edhe rastet e rekrutimit në disa pozita që nuk ka pasur kandidatë gjatë konkursit: keni shkuar në mënyrë të përshpejtuar. Mirë, po çfarë konkursi ka qenë ky që keni shkuar në mënyrë të përshpejtuar? Se po besoj që para 10 viteve nuk ka pasur mësimdhënës boll, edhe u shpall ndonjë konkurs jo me lëmi të njëjtë. Po tash çdo konkurs që hapet ka plot njerëz që kanë diploma, p.sh.,

te këta që konkurojnë për një vend pune konkurrojnë dreqi e di, diku 50 veta, nga ajo listë fiton 1–2, është lista pritëse. Pse ju tash mos me i marrë ata që janë në listë të pritjes, po me shpall konkurs? Pse kjo bëhet kështu? Ata që janë në listë të pritjes, a nuk kanë qenë të preferuarit e atij komisioni që i bënë? Ata që janë në listë të pritjes janë vetëm për sy e faqe? Ata duhet me i marrë, e jo me e shpallë konkursin në mënyrë të përshpejtuar! Tjetra: sa mësimdhënës i keni nga klasa e 6 deri në 12 me normë të plotë, dhe sa mësimdhënës janë jo me normë të plotë.

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: Elham, për raportin e punës i përmende edhe defektet për vitin 2025–2026, edhe për konkursin e vitit të kaluar, mungesën e orëve. Është e vërtetë që kemi pasë zvarritje në konkursin e vitit të kaluar, edhe pse me vonesë mësimdhënësit i kemi marrë dhe jemi munduar thuaj se shumicën, ose në përgjithësi mund me thanë që orët janë mbuluar, dhe janë munduar mësimdhënësit që t'i mbajnë orët shtesë për ato orë që janë humbur. Ndërsa është e vërtetë se personelin në Drejtorinë e Arsimit e kemi të vogël dhe kërkohet staf më shumë administrativ. Mirëpo ne e dimë që nuk varet prej komunës edhe numri i caktum i personelit, sepse ju edhe pse janë pak janë shumë të zot dhe besoj që po ja dalin që edhe punën e tyre me e kryer me vullnet. Mirëmbajtja sanitare: ne e kemi edhe kontratën me operatorin ekonomik, mirëpo për shkak të buxhetit në komunë... u dëgjua te shkolla e Gërmovës, po ka qenë një video. Ishemi atje në inspektim me thënë të drejtën, ajo video është hudhë poshtë, për arsye se shkolla na ka befasuar se sa ka qenë e pastër! Domethënë ajo video ka ra poshtë, edhe pse inventari është i dëmtuar, mirëpo është i përdorshëm, mundesh lirisht me shku me e vizitu, shkolla është në gjendje perfekte! Edhe pse thashë që inventar kemi të dëmtuar, po për momentin është i përdorshëm. Për printera: po ne si komunë e Vitisë kontratën e kemi me Centralin e Prokurimit Publik (AQP-në), mirëpo për tonerë ne e kemi kontratën tonë me operator ekonomik. Dhe çka është më se interesanti: AQP-ja i ka bërë vetëm për institucionet komunale, e jo për shkolla printerët, edhe nuk kemi mujtë me shpallë përmes prokurimit tender, se ata e kanë thanë që do të ketë për institucione, po jo për shkolla! Kështu që furnizohet vetëm komuna me printera, e për tonerë e kemi kontratën. Tabelat digjitale pse jo, edhe unë jam i pajtimit që të gjitha shkollat t'i kenë tabelat digjitale, mirëpo për shkak të buxhetit ne nuk kemi mundësi. Kërkesat e shumta që i kemi bërë në MASH, mirëpo edhe atje normal zvarriten e shkojnë me tenderë të ndryshëm. Shumë frikë ka kaluar edhe tenderi i inventarit atje, ku kemi bërë kërkesa që i kemi pasë vitin e kaluar, se këtë vit nuk na kanë marrë për bazë hiq! Shkollat e Pozharanit për mirëmbajtje nuk kam vërejtje; i kemi punëtorët teknikë, thuaj se në të gjitha shkollat punëtorët teknikë janë të zotë, por nganjëherë varet edhe prej materialit të higjienës sa kemi ne me ju ofru si DKA. Ndërsa sa i përket prindërve që po hyjnë në oborret e shkollave, është alarmante, jo vetëm në Pozharan, po thuaj se edhe në shkolla tjera. E nëse inspektorati i vendos shenjat, do të informohen organet kompetente dhe të mirren me këtë çështje. Jakup, objektet që kanë pikë vitin e kaluar: me të thënë të drejtën, shumica e shkollave që kanë pasur këtë problem kemi intervenuar, mirëpo mundet me ndodhë me piku tani për tani – nuk na pikë asnjë shkollë! Jemi munduar që të intervenojmë te të gjitha këto, edhe pse e patëm në një rast kur e patëm stuhinë në fshatin Skifteraj: shkollës komplet iu është dëmtuar kulmi, dhe aty kemi pasur më primare që ta rregullojmë atë objekt shkollor. Për dimër jemi përgatitur me kohë, i kemi marrë lëndët djegëse, kështu që thuaj se të gjitha shkollat janë të pajisura me dru, nuk e kemi problem. E te pikja e shkollës mundet me ndodhë që pikin, po e kemi operatorin dhe do të theksojmë të mundohemi që t'i evitojmë nëse ka dëmtime. Ekrem, te konkurset e rregullta, ta shpjegoj çështjen e listës së pritjes. Lista pritëse mund të bëhet në secilën lëndë, mund të jetë për edukim, mund të jetë për biologji, fizikë etj., etj. Problemin më të madh e kemi në fizikë, biologji, gjuhë gjermane, që kemi mungesë të kuadrove, dhe për këtë arsye do të përsëritet prapë konkursi. Kemi bërë listën pritëse për arsye që mos të kemi shumë shpesh konkurse të rregullta dhe t'i evitojmë konkurset e rregullta, e në momentin që hapet konkursi i rregullt, kjo listë bie poshtë. Mirëpo këtë listë zakonisht na e mbajmë për një vit, e mbajmë edhe për pushimet e lehonisë që ndodhë, se për exemplu janë një numër i madh i mësimdhënësve këtu që herë pas herë na duhet t'i zëvendësojmë, dhe jam munduar që me 1 shtator asnjë klasë të mos na mbetet pa mësimdhënëse dhe kemi filluar me sukses. Ndërsa sa i përket me normë të plotë dhe jo të plotë: secili mësimdhënës ka të drejtë që të marrë gjysmë norme, t'i ndajë orët dhe të paguhet vetëm për gjysmë norme, domethënë vetëm 10 orë t'i mbajë, duhet me bë kërkesë, atëherë ne marrim masa. Po problemi është se ne e kemi numrin e kufizuar në arsim, me

përjashtim të pushimeve të lehonisë, se ato nuk hyjnë në numër të mësimdhënësve të rregullt, aty kemi të drejtë. Ndërsa sa i përket që i kemi të rregullt, aty tani problemi na shfaqet kur të na lëshojnë orët, mirëpo na kemi pasë mundësi për arsye se kemi pasur mësimdhënës që kanë mujtë me marrë orë dhe e kanë bërë normën e plotë, dhe kështu nuk e kemi atë problem, se nëse e marrin gjysmë norme, nuk paguhen.

z.Ekrem Abazi: Besoj se rrallë mësimdhënëse, shumë rrallë, kërkon që me ju heq 10 orë. Po ju vetë ia jepni nga 10 orë, vetëm me u kyç aty, tani në të ardhme shumë shpejt me ja plotësu normën atij që e keni marrë ju për interesa tuaja, që i keni obligime ndaj tyre. Se e di si shkon kjo punë. A po thu, keta s'i gjen ti 5 mësimdhënësa që kërkojnë me pas normën jo të plotë? E di që ti mundesh me qenë viktimë e kësaj pune, se s'e kryen ti këtë punë, se nuk të lejojnë me kry ata vetë. Të dërgojnë emrat dhe nuk e keni çare pa i pranuar, se qashtu është rregulla, u bë rregull tek na dhe ju nuk mundeni me lëviz fare. Se krejt mësimdhënësit kërkojnë me pas orë të plota. Unë e pashë që për 4 orë po lujshin 150-200 euro, e pak ka asi që e kërkojnë gjysmë norme, po shumica janë që ju i merrni me gjysmë norme, që me i shti në sistem njerëzit e juaj që i keni obligim para zgjedhjeve. Se kurrë nuk kalon qajo që thave, është në listën e pritjes, ai nuk vjen në pyetje kurrë, se atë e keni lanë, edhe me qenë më i afërt, me përgatitje më të mëdha, ju vetëm me gjykatë se i merrni! Pa përgatitje shkollore ju kanë qitë në gjyq, keni raste. E me listën pritëse, ata që janë, ju jeni tu bë hajgare, se ata mendojnë që janë në listën pritëse. Në atë moment që kërkohet një mësimdhënës për qat lëndë, ai s'ia di farën, se atë s'e merr një hiq në start. E lini listën pritëse që mos me marrë kurrë, se nuk është personi që ju keni obligime ndaj tij, e nuk e merrni kurrë. Kjo çka bëhet në komunën tonë, te arsimi e te shëndetësia, është turp!

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: Ekrem, lista pritëse është publike. Në momentin që është publike, aty e din secili se kur i vjen rendi, kështu që unë nuk e anashkaloj asnjë që është në listën pritëse brenda vitit. Madje, thuajse të gjithë që kam pasur nevojë prej listës pritëse i kemi marrë deri në hapjen e konkursit të rregullt. E në momentin që merret mësimdhënësi, i nënshkruhet kontrata, dhe në momentin që i nënshkruhet kontrata, kam obligim që t'ia kompletoj orët. Pa marrë parasysh, unë orët ia kompletoj ashtu siç kërkohet në konkurs.

z.Ekrem Abazi: Ju ja kompletoni orët vetëm atyre që jeni të dirigjuar prej kryetarit, se absolutisht jo! Kjo punë bëhet vetëm për njerëzit që janë të afërt e ju që keni obligime ndaj tyre.

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: Ekrem, në konkursin e fundit është publik, është në web të komunës, mundesh me këqyr. Edhe në fund shkruan se ku i ka orët para se të merret mësimdhënësi, dhe aty gjithmonë janë orët ku i kanë dhe për sa orë kërkohet mësimdhënësi. Secili që ka të drejtën aplikon për ato orë që shpallen në konkurs përmes burimeve njerëzore.

z.Ekrem Abazi: Ka pa orë, ka! Pse me shpallë konkurs, kurse pa orë mundet me i plotësu ato orë një tjetër mësimdhënës? Ose shkoni prej Pozheranit e çoni në Buzovik, ose prej Skifteraj e çoni në Sllatinë, si shembull!

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: I nderuar, çështja e arsimit është më delikate dhe nuk mundemi mësimdhënësin e gjuhës shqipe me e çuar për matematikë!

z.Ekrem Abazi: Ka sa dush për të gjitha lëndët, vetëm për një konkurs! Kqyre sa konkurojnë, po disa nuk i merrni as në intervistë fare, se nuk janë militantë të partive. Këtë e bëjnë të gjitha partitë, edhe nuk janë me kushte të njëjta — lirisht me ta marrin lejen e LDK-së, se ka fitu LDK-ja. Po absolut, kushtet dallojnë, ata s'i merrni se nuk është në LDK.

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: Ka të drejtë secili qytetar përmes padisë me fitu vendin e punës.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Kjo pikë është veç informatë, nuk votohet, vazhdojmë me pikën tjetër.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratim propozim vendimin për vënien në shqyrtim publik Projekt Harten Zonale të Komunës së Vitisë 2026-2034

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: E dini që pas planit zhvillimor, për me u kompletu plani zhvillimor, duhet të kalohet edhe dokumenti i dytë: hartat zonale. Harta zonale e dini që është në punim e sipër gati që 1 vit me procedurat, puntorët që kanë vazhduar deri tani për ta dërguar në ministri. Dhe kalohet në procedurë

kur kuvendi ka për detyrë me e shpallë në diskutim publik. Diskutimi publik, pasi ta kthen ministria, do të jetë për 30 ditë. Gjatë 30 ditëve kemi mundësi ta diskutojmë planin me ekspertë, kompani, drejtori.

zn.Zyrafete Rama, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ky propozim-vendim është bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Vitisë, si dhe Rregulloren e Kuvendit Komunal. Drafti fillimisht i është dërguar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për mendim paraprak. Komuna, së bashku me kompaninë hartuese të hartës zonale, i ka kryer të gjitha korrigjimet dhe procedurat ligjore. Fatkeqësisht, ministria për një kohë të gjatë na ka mbajtur në pritje, dhe ne, në harmoni me ligjin dhe aktet normative, kemi vendosur t'i zbatojmë dispozitat ligjore lidhur me heshtjen administrative. Para vetes keni draftin e Hartës Zonale të Komunës së Vitisë 2026–2034, së bashku me të gjitha proceset administrative dhe ligjore të zhvilluara. Prandaj, ju ftoj që ta mbështesni këtë propozim-vendim!

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Unë edhe në KPF kërkova që, gjatë diskutimit që është për 30 ditë, ta kemi një takim vetëm me anëtarët e kuvendit, që të njoftohemi më mirë në detaje, e që kur të miratohet në kuvend me pasë njohuri më shumë.

z.Basri Aliu: Unë e përgëzoj drejtoreshën për iniciativën e marrë për me e sjellë në kuvend, se edhe ashtu kërkesat janë që sa më shpejt të kryhen edhe këto hartat zonale, në mënyrë që të fillohet të punohet edhe ligjërisht në ndërtim në Komunë të Vitisë. Andaj, unë e përkrah këtë iniciativë.

z.Visar Demiri: Plani zhvillimor dhe hartat zonale janë dokumentet më të rëndësishme të planifikimit të Komunës së Vitisë, dhe si dokumente shumë të rëndësishme i japin kahje zhvillimit të komunës së Vitisë. Shqyrtimi publik i jep mundësi qytetarëve që të bëhen pjesë e hartimit të hartave zonale dhe t'i mbrojnë interesat e tyre gjatë këtij procesi. E përgëzoj drejtorin dhe kompaninë që kanë bërë punë, veç dokumenti ka ardhur gati në fund, dhe si dokument e përkrah.

z.Jakup Demiri: E rëndësishme është që me u ditë: ne prej sotit, kur mundemi me mbajtë këtë takim me kompaninë dhe subjektet politike? Po them ashtu, se ne kemi mundësi që të marrim edhe ndonjë njeri që është profesionist me vete në takim. Ne e dimë që harta zonale buron nga Plani Zhvillimor Komunal dhe nuk ka mundësi me i ikë asaj që nuk është në plan, dhe nga ajo duhet të rrjedhë kjo. Ne, si grup, e mbështesim këtë dhe presim që të bëhet më e mira e mundshme.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Jakup, duhet me na e kthy ministria që ne duhet me e qitë në diskutim publik. Varet sa na vonon ministria, se e ka këtë afatin 30 ditë, dhe për këtë nuk mundemi me caktu [datën], por në momentin që na kthen ministria, ne e caktojmë një ditë. Pasi që nuk ka më për diskutime, kërkoj për votim: pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, [dhe] asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pike.

Si pikë e tetë e rendit të ditës:

8. Pyetje dhe përgjigjje

z.Jakup Demiri: Pyetje për nënkryetarin: Te problemi i ujit të pijes në Komunë të Vitisë: të shtunën më ka dërguar një qytetar prej Trestenikut një video të ujit të pijshëm që është krejt i turbullt. Ku e keni gjendjen e ujit të pijes në ujësjellësin e Komunës së Vitisë? Në disa trotuare që kanë qenë të papërfunduara ka një kohë të gjatë, por në disa trotuare a do të përfundojnë, se nuk ka shumë punë, por me i përfundu do të ishte mirë? Dhe pyetja tjetër ka të bëjë me këto mbeturina që po i qesin qytetarët: Drejtoria e Inspektoriati çka ka vepruar, se territori i komunës sonë është alarmant me mbeturina nëpër fusha e ledina, është e tmerrshme! E di që është problem me e menaxhu, por a ka gjoba të shqiptuara?

z.Nuhi Ramadani: Kam dy kërkesa. Njëra prej "Sokolëve" dhe "Kecëve": ata kërkojnë që në hyrje prej Goshicës dhe daljes prej Verbanit, nga Goshica në udhëkryq, të vendosen dy pengesa në distancë 30 metra njëra prej tjetrës. Arsyeja është që në atë udhëkryq po lëvizin veturat me shpejtësi marramendëse. Dhe kërkesa tjetër, që e kam bërë edhe më herët: kanalizimi është nxënë që 5 muaj. Kërkoj që me e kontaktu kompaninë që është marrë me atë punë, sepse ka marrë sipërfaqe të madhe të tokës dhe e ka dëmtuar.

znj.Elsa Jahija: Furnizimi me ujë të pijshëm mbetet nga nevojat më urgjente të qytetarëve të Vitisë. Për shumë familje kjo është një çështje e përditshme, prandaj kërkon vëmendje dhe investime të vazhdueshme nga komuna. Duke parë investimet e viteve të fundit, konsideroj se nuk është bërë mjaftueshëm për t'i dhënë

zgjidhje këtij problemi. I nderuari nënkryetar, së fundmi është bërë e ditur se Komuna e Vitisë është përfshirë në një projekt të Bankës Botërore për rritje të kapaciteteve të furnizimit me ujë të pijshëm, përfshirë ndërtimin e një impianti të ri për trajtimin e ujit në Letnicë. A mund të na jepni një përgjigje konkrete: në cilën fazë ndodhet aktualisht ky projekt, cilat janë hapat e radhës dhe kur pritet të kemi një afat konkret për fillimin e realizimit të tij? Qytetarët e Vitisë kanë nevojë të dinë se kur ky projekt nise të japë rezultate në furnizimin e tyre me ujë të pijshëm.

z.Elham Emërllahu: Një problematikë që dua ta ngris këtu i drejtohet Drejtorisë së Mirëqenies Sociale. Të gjithë jemi dëshmitarë që javët e kaluara ose muajt e kaluar ka pasur disa raste të sulmeve fizike ndaj stafit shëndetësor, të mjekëve dhe infermierëve, në Komunën e Vitisë. Edhe unë personalisht, bashkë me Sindikatën e Shëndetësisë në protestën e fundit që ata e kanë organizuar, i jam bashkangjitur. Edhe bazë të bisedave, por edhe të kontakteve që kemi pasur me ta, ata kanë shprehur shqetësim se nuk ka siguri të mjaftueshme në ushtrimin e detyrës të cilën e kanë, dhe nuk e di çfarë ka paraparë komuna dhe drejtoria. Por ata i kanë disa kërkesa, kanë qenë edhe publike; njëra prej tyre ka qenë sigurimi fizik në objektin e QKMF-së në Viti dhe Pozheran, për faktin se nuk ka qenë pasqyrë e mirë që Komuna e Vitisë me u bë lajm për sulme fizike ndaj stafit shëndetësor, dhe nuk e di çfarë hapa janë ndërmarrë. Pyetjen tjetër që dua ta përsëris, që e kam bërë edhe në muajin prill për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, janë pyetjet e njëjta, vetëm se përgjigja e tij ka qenë "çështje jave apo dite që kanë me fillu punimet". Është fjala për stadiumin e qytetit në Viti dhe për stadiumin e Vllaznisë së Pozheranit, për tribunat edhe për nevojat e tjera të cilat i kanë ata. Domethënë, kanë kaluar disa muaj dhe unë nuk kam informata dhe nuk kam parë që është bërë diçka për stadiumin e qytetit të Vitisë apo për stadiumin e Vllaznisë së Pozheranit. Në aspektin e sportit, Komuna e Vitisë ka qenë jashtëzakonisht e afirmuar, ka disa sportistë individualë që kanë arritur edhe gara ndërkombëtare, botërore, tituj – siç është rasti i kickboxeres nga Vitia. Po klubet futbollistike dhe klubet e tjera janë duke pasur vështirësi të mëdha, andaj kisha kërkuar prej drejtorit me na sqaru çka është puna tash.

zn.Mirjeta Hamiti: Përshëndetje për të gjithë! Pasi që e pamë te projektet investive publike është si pikë edhe ndërtimi i trotuareve dhe rivitalizimi i tyre, dua ta di: a kanë me u trajtuar me prioritet kërkesat që kemi bërë për rregullimin e trotuarit te shkolla në Dobresh, duke e pasur parasysh që është shkolla me rritje të numrit të nxënësve?

zn.Liridona Bislimi: I nderuar nënkryetar, te mbledhja e KPF-së e kam ngritur një çështje për diskutim, e cila ka të bëjë me kërkesën e banorëve të fshatit Dobresh për rregullimin e ndriçimit publik te fusha e vrapimit. Domethënë, ta kam shpjeguar interesin që e kanë për këtë pjesë, sepse është duke u shfrytëzuar shumë, dhe jo vetëm nga banorët e fshatit Dobresh, por edhe të vendeve përreth. Andaj, dua një sqarim: a keni diskutuar ose shqyrtuar si mundësi që me u bë realizimi i kësaj kërkese? Dhe çështja tjetër: për shkollën në Dobresh – është një ndër lokalitetet ku ka rritje të madhe të regjistrimit të nxënësve, dhe dua të koncentrohem më shumë tek pjesa e çerdhes publike. Prej takimeve që kemi pasur me prindërit, ka qenë kërkesë specifike e tyre për me pasur një kënd të lojrave, për shkak se e dimë që në një çerdhe pjesë e aktiviteteve të fëmijëve është edhe pjesa e lojrave të cilat ata duan me i shfrytëzuar. Andaj, drejtoreshë, dua ta di: a e keni analizuar këtë çështje, a e keni menduar me e pasur si planifikim të buxhetit për aktivitetet e viteve në vazhdim? Edhe një kërkesë që ka qenë e vazhdueshme dhe temë diskutimi nga studentët natyrisht që janë bursat: ka kaluar viti akademik, drejtoreshë, nuk e di se kur keni me bë shpërndarjen e bursave. Ka dalë lista e emrave që janë pranuar, por shpërndarjen e mjeteve nuk e keni bërë, andaj edhe këtu dua përgjigje se kur ka me u bë ndarja e mjeteve.

z.Basri Aliu: Një kërkesë te Drejtoria e Kulturës dhe Sportit: duke e ditur gjendjen e arkivës së komunës, se në çfarë gjendje është, kisha dashur që iniciativa e një projekti të merret pak më seriozisht, jo vetëm ti por gjithë qeveria komunale, në mënyrë që arkiva dhe dokumentacionet të cilat janë – edhe të pakta që kanë mbetur – të kthehen në gjendje më të mirë, në mënyrë që t'i shfrytëzojnë qytetarët e Komunës së Vitisë. Sepse në podrum atje, sa e di, është një gjendje e rëndë, andaj kisha dashur ta merrni parasysh këtë. Dhe lidhur me rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës, po e bëj si pyetje për arsye se kam pasur disa kërkesa prej zyrtarëve komunalë që ta parashtroj: pasi që herën e kaluar nuk kaloj statutit [statuti], atëherë ku ka mbetur kjo çështje dhe a do të presim që të delë para kuvendit?

z.Ilir Zuka: Kam një pyetje dhe një falënderim për nënkryetarin: në mbledhjen e fundit të KPF-së e kemi ngritur një shqetësim – trotuari te shkollat e mesme në Pozheran u bllokohej prej veturave, dhe falë intervenimit të shpejtë është liruar trotuari, pasi që është në kujdes gjatë orëve të shkollës, janë në mbikëqyrje edhe nga policia, gjë që është bërë punë e mirë. Dhe mundësisht, vijat për këmbësorë me u shënuar, se janë fshirë të gjitha dhe është rrezik për fëmijë.

z.Ekrem Abazi: A keni bërë përpjekje këtu, nënkryetar dhe drejtori përgjegjëse, për me gjetë një hapësirë për ndërtimin e banesave sociale? Kanë përfituar 21 komuna, ka komunë që ka fituar 4.4 milionë euro. Ju a keni bërë të paktën një përpjekje me gjetë një hapësirë me i ndërtu ato banesa? Dhe pyetja tjetër, për shëndetësinë: isha një ditë te analizat, te hyrja aty në katin e parë, ishte e pambuluar një pjesë, vetëm dritarja natën [ose pjesa e hapur] dhe aty fasada kish ra, dhe ajo pjesë ish bë sikur me qenë kotec i pulave! Me një investim shumë të vogël – bile një mjek tha mundemi me bë depo të barnave, por edhe mos me bë depo, ish turp me pa se në çfarë gjendje ishte. Një fotografi e kam, mundesh me e pa, drejtor.

z.Faruk Shabani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kam dy çështje për fshatin Ramnisht: pyetja e parë është që ndriçimi mungon qe një muaj Viti–Ramnisht; dhe pika tjetër, kërkesë prej fshatit të bëhen pengesa në rrugë, për shkak se në udhëkryqin Ramnisht–Viti–Mogillë–Beguncë kemi problem gjithmonë me aksidente, e rastet e fundit i kemi pasur edhe me fatalitet. Kërkojmë nga organet kompetente të marrin masa konkrete, të bëhen pengesa në rrugë, që të mos kemi telashe me fëmijë, sepse aty kalohet për me shkuar në shkollë. Edhe pse e dimë që ministria e ka për rregullimin e kësaj, mirëpo ne duhet me bë kërkesën që të kemi polic të shtrirë në rrugë. Këtë e kërkojmë se në fshatin Verbovc në të njëjtën rrugë ka pengesa, ndërsa në fshatin tonë nuk është pranuar.

z.Halil Musliu, drejtor: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ju e dini që kanë qenë dy sulme në shtëpinë e shëndetit ndaj stafit mjekësor; kanë qenë të paprovokuara dhe të paimotuara nga stafi dhe puna e tyre. Domethënë, është e pamundur ne me i ndalu elementët kriminalë në një mënyrë derisa nuk ka asnjë element që atakon, që më provokon, kanë ndodh si kanë ndodh. Unë kam mbajtur takim me menaxhmentin e QKMF-së, por edhe me stacionin policor për ndërmarrjen e masave, gjithashtu dhe jemi në procedurë rreth çështjes së ofrimit të sigurisë për punonjësit shëndetësorë. Nuk është problemi numër një aty për arsye se te sulmi i parë ka qenë policia në vend të ngjarjes edhe ka ndodh sulmi; ndonjëherë është e pamundur elementët kriminalë me i ndalu pavarësisht çfarë sigurimi ke. Edhe jemi marrë vesh që në të ardhmen të ndërmarrim masa, të sigurojmë kushte të sigurisë, por ju e dini që në kodin buxhetor nuk lejohet që të ketë punëtorë që paguhen [në këtë formë], por po e shqyrtojmë mundësinë e kontraktimit të shërbimeve. Por nga ajo që kemi llogaritur, minimum duhen 7–8 punëtorë, për shkak se i kemi dy qendra të mjekësisë të cilat punojnë 24 orë, dhe gjendja financiare që kemi nuk na lejon një komoditet të tillë. Në momentin që krijohen mundësitë e para që të stabilizohemi financiarisht, ju e dini që kriza financiare që është shkaktu veç, domethënë e kemi në agjendë – po besoj që muajve në vijim do të zgjidhet kjo çështje. Te kjo te analizat që u tha, është fakt, se e kam vërejtur edhe unë, i kam vizituar të gjitha qendrat e ambulancave dhe jo vetëm një herë, për shkak se kemi pasur edhe stuhinë që ka shkaktuar dëme dhe kemi bërë një incizim të gjendjes. Kemi një 7–8 vende ku duhet me intervenu, por kemi vetëm 60 mijë euro për investime: 30 mijë jemi shtrënguar me i bë furnizimi me pajisje medicinale, 30 mijë na kanë mbetur për renovim. Ne tash kemi bërë një listë prioritare, p.sh.: aty ku është pamundësuar zhvillimi i punës normale kemi intervenuar; në Goshicë, Remnik kemi intervenuar kulmin edhe kemi bërë rregullimin. Mundësitë financiare kaq i kemi, prioritetet i kemi bërë.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Po, ju përgjigjem Elhamit rreth stadiumit të qytetit dhe tribunave në Pozheran. Për njoftim, Elham: te stadiumi i qytetit veç kemi filluar punët, ka filluar gërryerja e bazës së stadiumit të qytetit. Normalisht që punët, për shkak të mungesës së kapaciteteve buxhetore, janë duke na shkuar shumë më ngadalë sesa kemi dëshirë, por tash më kemi një memorandum me Federatën e Kosovës: pjesën e bazës e kemi me e kry komuna, jemi në proces e sipër, punët veçse kanë filluar, kurse pjesën tjetër, tapetin dhe zhveshtoren, e ka marrë përsipër me e kry Federata e Futbollit të Kosovës, dhe urojmë që të përfundohet sa më shpejt. Rreth tribunave të stadiumit të Pozheranit: menjëherë në seancën tjetër ne kemi marrë një vendim për rialokimin e mjeteve në shumë prej 40 mijë eurosh për projektin e tribunave të stadiumit "Ibrahim Kurteshi" në Pozheran.

Fatkeqësisht, edhe në këtë projekt na kanë ndërhyrë përmbaruesit, të cilët kanë ndërhyrë në secilin projekt në Komunën e Vitisë, por jemi në proces dhe në koordinim edhe me Ministrinë e Sportit. Dje është dorëzuar në Ministrinë e Sportit, bile kemi punuar së bashku me inxhinierët, e kemi dorëzuar në Ministrinë e Sportit bashkë me të gjithë projektin detal dhe kemi marrë zotimet se do të futet në planifikimin buxhetor të Ministrisë së Sportit dhe Rinisë për vitin 2027 si një nga projektet më të rëndësishme për Komunën e Vitisë, por në veçanti për stadiumin e Pozheranit. Ndërsa, për arkivën e qytetit: e para, pajtohem me konstatimin dhe shqetësimin, sepse në vazhdimësi jam munduar, edhe konstatimet reale kam dëshirë me i marrë, sepse veç kështu ne mundemi me e ndryshuar gjendjen; duke i pranuar gabimet e sfidat, mundemi me e ndryshuar gjendjen reale. Brenda autorizimeve dhe kapaciteteve tona, një hapësirë lart te Shtëpia e Kulturës, për një material të ndjeshëm, e kemi lëshuar edhe kemi vendosur një material të ndjeshëm të arkivës. Por këtu është një problem: qeveria e Republikës, parlamenti, vitin e kaluar e ka implementuar ligjin e ri shtetëror për arkivat, ku sipas ligjit të ri komunat nuk lejohen të kenë tamam arkiv shtetëror, por bëhen arkivat rajonale. Domethënë, një pjesë e madhe që gjendet në arkivin komunal të Vitisë do të kalojë në arkivin rajonal që është në ndërtim e sipër në Gjilan – një vendim që për mua ka qenë i papranueshëm, sepse qytetarit ia largon shërbimet. Por megjithatë, ky është vendimi edhe ne duhet me e implementuar. Në këtë kontest kemi pasur edhe neglizhencë, sepse bashkë me Arkivin Qendror të Kosovës kemi edhe një marrëveshje ku kemi me filluar digjitalizimin e arkivit komunal. Por pajtohem me krejt shqetësimet e tua dhe do të mundemi që brenda mundësive me intervenuar në atë pjesë që është shumë sfiduese.

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: E nderuara znj. Liridona, për fshatin Dobresh që e kemi çerdhen afër shkollës, për një kënd të lojrave, me thënë të drejtën në planifikim e kam futur te e domosdoshmja, por jo gjithçka që është e nevojshme; për shkak të buxhetit nuk kam mundur ta planifikoj. Mirëpo, kemi fituar një projekt përmes ministrisë, me një organizatë italiane, kemi fituar trajnimin e edukatoreve dhe një kënd të lojrave, dhe do ta kem parasysh nëse më jepet mundësia, pse jo, edhe në fshatin Dobresh. Ndersa, për bursat: këtë vit kanë përfituar 152 studentë; për shkak të kufizimeve buxhetore kryetari nuk ka mundur ta rrisë numrin e përfituesve, prandaj komisioni ka proceduar me kriteret e parapara me rregulloren. Sipas informacioneve që kam, tash kanë përfunduar edhe procedurat ankimore dhe jemi në fazën e përgatitjes së listave për financa, ku besoj që shumë shpejt do t'u dalin mjetet.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Jakup, për çështjen e ujit të Trestenikut e kemi lidhur kontratën, kam pasur edhe takimin e fundit, të cilët janë në pritje të pompave, dhe po besoj që problemi dalëngadalë do të zgjidhet një herë e përgjithmonë, ku do të kalojnë në menaxhim të "Hidromoravës" që tani, dhe Instituti për Shëndetin Publik bën kontrollimin e tyre. Tash e di që momentalisht është uji i pakontrolluar, edhe pse ju shkon te shpia. Çështjen e mbeturinave do ta shtroj te drejtori që nuk është këtu; megjithatë, e pashë një pengesë ligjore, domethënë ka dalë një pengesë që tash, derisa kanë pasur të drejtë inspektorët në dënime, tash kish ardhur që ato dënime në aspekt administrativ, sipas ndryshimit të një ligji, duhet sipas gjykatës, dhe unë besoj që kish me na mbushur me bërllok hala më shumë. Pengesat në rrugë: e ke inspektorin e komunikacionit, shkon e bën kërkesën, del në vend të ngjarjes dhe besoj që ato çështje kalojnë. Elsa, është e vërtetë që është fituar projekti, kontratën, kam pasur takim me ta, kanë qenë në Viti, kam biseduar edhe me mbikëqyrësin edhe me kryerësin: sipas të gjitha gjasave ka dalë një pengesë se disa rrugë të cilat i kanë lënë kanë dalë jashtë asaj sipërfaqeje që i kemi shpronësuar ne këtu, dhe tash janë në modifikim të projektit, por shpresoj që së shpejti duhet me ia nisur. Ndërtimi i trotuareve, e përmendi Jakupi dhe të tjerë. Me të gjithë ata të cilët kemi pasur kontratë i kemi thirrur në zyrë, kemi biseduar dhe kemi shtruar presion me dalë. Unë besoj që kanë me ia filluar, ashtu janë zotu, shumë po frigohem se a kemi me mundur me iu nejtë prapa, gati se ashtu është gjendja; kjo pengesë kështu vlen edhe për Dobresh. Liridona, pas bisedës që kemi pasur në KPF, kam shkuar të njëjtën ditë, e kam shqyrtuar: aty janë të parapara edhe dritat edhe shumë objekte tjera përcjellëse, por këto mungesa e parave që po na e merrni, nuk po them që me ta qitë ty, por urdhnoni, merreni ndikimin në qendër i përfundojmë disa objekte që janë të rëndësisë së veçantë, në këtë rast edhe të palestrës edhe të objekteve përcjellëse që do të ketë ndriçim, se aty është bërë një kompleks i mirë që shfrytëzohet nga gjithë qytetarët. Rregulloren, Basri, e kam diskutuar me kryetarin, me komisionin, e kanë në përfundim, ndoshta mbledhjen e

ardhshme e bijnë. Ilir, atë çështje që kam mundur me e kry, e kam kryer; atë tjetrën e kam shtruar me dalë me caktuar vijat ku janë për këmbësorë, që me ia lehtësuar edhe policisë kur e ushtrojnë detyrën e vet, ta shohim se çështje e tenderit, mos janë harxhuar mjetet, ta shohim çka mundemi me bë. Ekrem, përpjekje jemi duke bërë për atë çështje. Faruk, ndriçimin publik mundem me e shtru, dhe kam pasur disa qytetarë që ma kanë shtruar formën e pengesave: e vetmja formë që mendoj që mundet me shku është me frekuentuar zyrën e inspektorit, dhe inspektori me iu drejtuar ministrisë përkatëse të cilën e administron atë rrugë. Domethënë, me një kërkesë nga këshilli i fshatit i drejtohesh inspektorit, inspektori ju drejtohet; nëse e ka koordinimin në vijë me ministrinë përkatëse, besoj që bëhet zgjidhja.

z.Ekrem Abazi: Unë këtë punë të msitnis s'po e di çka është kjo; ndoshta është që 2–3 muaj keni pasur veç me apliku, komunat tjera nuk kanë çuar "msit" hiç, veç kanë aplikuar dhe kanë fituar. Ne shpeshherë e thojmë "Komuna ime, shtëpia ime", por jo me pas qenë për interesa tona personale, se unë dhe ju bashkë nuk kishim lanë gur pa rrotulluar pa fituar, nuk e kishim lanë! Por ka qenë për qytetarë që kanë qenë pa strehë dhe nuk na ka interesuar fare; ata i dujmë veç kur na vijnë për vota! Kjo është totalisht e papranueshme për mua. Kanë përfituar komuna që janë shumë më të pasura se na dhe kanë fituar.

zn.Liridona Bislimi: Nënkryetar, pata tri çështje që i përmenda: domethënë, te ndriçimi publik te fusha e vrapimit në Dobresh, bursat për studentë dhe këndi i lojrave. E kemi pasur përmendur me kolegun Ilir që e ceku çështjen e dëgjimeve buxhetore që po i mbani, dhe që kemi pasur kërkuar që me u stagnu kjo farë pune. Një ndër çështjet që lidhen me këto janë tri kërkesa; unë besoj që nëse e kishe mbajtë takimin prej momentit kur është bërë kjo fushë sportive – nëse kishe mbajtë takimin me banorët e fshatit Dobresh dhe atë rrethinë – një ndër kërkesat kryesore kishte me qenë kjo. Çerdhja në Dobresh është finalizuar, por në momentin kur është finalizuar është dashur me u mendu këndi i lojrave, se e ka rëndësinë e vet të veçantë. Tash unë po e përgëzoj drejtoreshën për këtë mundësi që paska, mirëpo kërkesat e banorëve janë të tilla. Për këtë dua me u ndërlidhur për dëgjimet publike që po i mbani, të cilat në fund të fundit nuk po e kanë asnjë efekt të vetëm, për shkak se kërkesat po janë shumë të dukshme dhe po janë të përsëritshme dhe të vazhdueshme. Fushën sportive e ke ndërtuar që një kohë shumë të gjatë në Dobresh, e katër herë është qe e përsëris këtë kërkesë: tash prap ke me mbajtë dëgjime publike, prap ki me marrë këtë kërkesë dhe nuk ka me u realizuar! Përderisa kontrata kolektive ekziston nëpër komuna tjera, pse ne po jemi e vetmja komunë që po i kemi këto problematika? Që, ku e ke Gjilanin: prej 17 marsit e ke shpallur konkursin, [e te ne akoma] nuk i ke shpërndarë mjetet.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Po dallojnë ndryshimet, se në komunën tonë po jepen nga 4 euro për kokë banori, e në Gjilan po shkon ndryshe.

z.Jakup Demiri: Nënkryetar, kur erdhëm prej pauzës, disa punëtorë që pastrojshin te parku thanë: "Folni në kuvend se pagat qe 3 muaj nuk i kanë marrë". Kjo është për mua më e rënda, kur këta njerëz nuk marrin paga! Ne më mirë është mos me dalë në Viti, kur e dimë se çfarë gjendje e kanë ata.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka më për debat, me kaq e përfundoj këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00 min

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

_____

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi

_____